



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në ministrinë e Brendshme”.
2. Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Artemis Malo, Elona Hoxha Gjebrea, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Lefter Maliqi, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Arben Elezi, Nimet Musai, Adnor Shameti.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Duzha, Luan Harusha, Myslim Murrizi, Edmond Stojku.

Të ftuar:

Bledar Çuçi – Ministër i Brendshëm

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Elena Pici – Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

HAPET MBELDHJA

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi, kolegë!

Çelim mbledhjen e Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare. Kourumi është i plotësuar. Sot në rendin e ditës të mbledhjes ne kemi njoftuar dy pika për diskutim. Pika e parë e rendit të ditës është shqyrtimi i një propozimi, i bërë nga disa kolegë të nënkomisionit për zbatimin e ligjit për vetingun në Policinë e Shtetit, Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave dhe Gardën e Republikës, pra është propozuar nga kolegët të këtij komisioni një ndryshim në ligjin nr, 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik për punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës dhe të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme”. Relator për këtë projekt është kolegu ynë, zoti Vorpsi, që është njëkohësisht edhe sekretar i nënkomisionit për monitorimin e zbatimit të ligjit të vetingut.

Ndërkohë, si pikë të dytë të rendit të ditës, kemi shqyrtimin nen për nen të projektligjit “Për Gardën e Republikës”, ku relatores është zonja Malo.

Të ftuar për të diskutuar për pikën e parë të rendit të ditës, por natyrisht edhe për pikën e dytë të rendit të ditës, kemi ministrin e Brendshëm, zotin Bledi Çuçi.

Faleminderit, zoti Ministër!

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Sigurisë!

Edhe punë të mbarë, në emër të të gjithë kolegëve, meqenëse është hera juaj e parë në këtë komision!

Kemi po ashtu, zëvendësministrin, zotin Julian Hodaj, sekretaren e përgjithshme, zonjën Elena Pici dhe drejtorin juridik, zotin Fatmir Shehu.

Me qenë se edhe zoti ministër më ka shkruar, që të mund të jemi sa më efektiv me kohën edhe për shkak të axhendës së tij, por edhe ndërkohëpme dëshirën për të qenë pjesëmarrës në mbledhje të Komisionit të Sigurisë, unë do ia kaloj menjëherë fjalën zotit Vorpsi, për të prezantuar nismën e marrë nga kolegët e nënkomisionit parlamentar për zbatimin e vetingut në radhët e Policisë së Shtetit, SHÇBA-së dhe Gardës së Republikës.

Fjala është për ju, zoti Vorpsi.

Sadi Vorpsi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar zoti Ministër,

Në radhë të parë, dua të falënderoj të gjithë ata kolegë të cilët premtuan, formësuan këtë projektligj dhe normalisht edhe me mirëkuptimin e ministrit aktual. Ishte bërë e nevojshme në

fakt, për të ndërhyrë dhe për të përmirësuar eficiencën e vlerësimit kalimtar dhe periodik, sipas parashikimit të ligjit nr.12 të viti 2018, të ndryshuar, duke orientuar punën e Komisionit të Jashtëm të Vetingut, së pari te porcesi i vlerësimit për trupën vlerësuese të SHÇBA- së.

Bazuar në raportimin e fundit të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, pranë nënkomisionit parlamentar për mbikëqyrjen e ligjit, ku edhe unë jam në cilësinë e anëtarit dhe të sekretarit të këtij nënkomisioni, që kur ka filluar punë ky komision, deri në dhjetor të vitit 2020 kanë përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar vetëm 32 subjekte, do të thotë, nëse ne do të vazhdojmë me këtë ritëm i bie që duhet një periudhë gati 10-vjeçare, që ta mbarojmë këtë proces që më duket totalisht i pakuptimtë.

Prandaj, ky ndryshim do të mundësonte fokusimin dhe përmbylljen në kohë për trupën vlerësuese të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, i cila më tej do të mund të shtrinte objektin e vlerësimit kalimtar dhe periodik në subjekte të tjera të ligjit. Mekanizmi i parashikuar në ligjin ekzistues bashkë me ndryshimet e ndodhura në ligjin nr. 74 të vitit 2020, parashikonte që Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit do të vlerësonte kategoritë e punonjësve të përcaktuar në nenin 6 të ligjit, ndërsa punonjësit e tjerë do të vlerësoheshin nga SHÇBA-ja, bëhet fjalë për nivelin e mesëm të punonjësve të policisë.

Vlen të theksoj se ky ndryshim i propozuar nga disa kolegë deputetë, vjen edhe në përputhje e rekomandimet e GRECO-s, i cili është një institucion mjaft prestigjioz i Këshillit të Europës, një vrojtues i shtetit të së drejtës dhe GRECO, realisht rekomandon që funksionet më të ekspozuara ndaj riskut dhe integritetit, të trajtohen me përparësi gjatë procesit të vetingut, në lidhje me planin e integritetit të mjetet e tjera ekzistuese të menaxhimi të riskut, si dhe që kontrollet për integritetin e kandidatëve të kryhen në kontekstin e ndryshimeve të postit dhe ngritjes në detyrë dhe në interval të rregullt gjatë karrierës së punonjësve të Policisë së Shtetit.

Sa më sipër, duke vlerësuar procesin e vetingut deri më tani dhe rekomandimet e partnerëve tanë ndërkombëtarë, unë do t'u propozoj kolegëve deputetë ta miratojmë sot këtë projektligj, i cili për mendimin tim është shumë i nevojshëm, për të rritur eficiencën e këtij procesi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi!

Edhe për rekord, jo vetëm për të gjithë kolegët që janë të informuar për nismën e propozuar nga e nënkomisionit parlamentar të vetingut, por edhe për publikun, që besoj se është i interesuar për vetë Policinë e Shtetit, për Gardën e Shteti dhe për SHÇBA-në, ndryshimi i propozuar ka këtë përmbajtje, pra shtohet neni 68 me përmbajtjen sa më poshtë vijon: “Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve së Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës pezullohet deri

në përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar të trupës së vlerësimit të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”. Pra, ky është neni 68 që propozohet të shtohet në përmbajtje të ligjit nr. 12/2018 si një dispozitë kalimtare e këtij ligji. Ky është propozimi i bërë.

Besoj që në këtë pikë më duhet t’ia kaloj fjalën ministrit të Brendshëm, për të marrë edhe opinionin e Ministrisë së Brendshme, sepse procesi i vetingut është një proces i iniciuar me iniciativë të Ministrisë së Brendshme dhe natyrisht, mbështetur edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, ndërkohë që dua të nënvizoj, që për asnjë rast ne kemi mohuar dhe nuk mohojmë rëndësinë e këtij procesi, por në çdo kohë duhet të jemi të kujdesshëm, që mekanizmi të jetë efektiv dhe t’i përgjigjet vërtet kësaj nevojë që ne kemi, për të pasur njerëz sa më dinjitoz në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në Shërbimin e Çështjeve të Brendshme të Ankesave. Ky ka qenë në fakt edhe qëllimi i të gjitha ndërhyrjeve të bëra deri më tani në ligj apo edhe i të gjitha mbledhjeve që ka zhvilluar nënkomisioni parlamentar për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, duke thirrur këtu përfaqësuesen e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit apo duke shkuar disa herë vetë në mjediset ku ky komision është duke zhvilluar këtë veprimtari.

Fjala është për ju, zoti Ministër.

Faleminderit!

Bledar Çuçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Ashtu siç e thatë ju, zonja kryetare, qëllimi i ligjit të vetingut ishte absolutisht në dobi të forcimit të integritetit të figurës të punonjësit të Policisë së Shtetit dhe në përgjithësi të institucionit të Policisë së Shtetit. Ky qëllim mbetet i tillë, por që në ditët e para të punës si ministër i Brendshëm, jam ballafaquar me disa probleme serioze që kishin të bënin me ecurinë e procesit, sipas mënyrës që është e parashikuar deri tani në legjislacion, me gjithë ndryshimet dhe tentativat të ndërmarra nga Kuvendi i Shqipërisë, për ta përmirësuar këtë proces. Unë jam përballur me të gjithë problematikën që është hasur, deri tani në zbatimin e këtij ligji, problematikë e cila ka ardhur nga vetë institucionet që brenda qeverisë, brenda Ministrisë së Brendshme, lidheshin me zbatimin e kiji ligji, probleme që kanë ardhur nga raporti që ju, si komision përgjegjës për monitorimin në bazë të ligjit kemi hartuar apo keni marrë nga vetë Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, probleme që kanë ardhur nga partnerët që asistojnë ministrin e Brendshme dhe qeverinë në fushën e sigurisë, partnerët strategjikë dhe probleme që sigurisht janë evidentuar edhe në raportin e fundit, siç tha edhe relatori, zoti Vorpsi, në raportin e fundit të GRECO-s.

Të gjitha këto probleme janë analizuar edhe nga ne me shumë kujdes dhe unë jam shumë i kënaqur që Komisioni për Sigurinë Kombëtare e ka trajtuar me shumë seriozitet të gjithë ecurinë e këtij procesi dhe sot dy prej, apo nuk e di sesa po prej deputetëve të këtij komisioni, kanë arritur të propozojnë një ndryshim, që në gjykimin tim si ministër i Brendshëm, është i domosdoshëm dhe si përfaqësues i qeverisë shqiptare, shpreh dakordësinë time të plotë me këtë variant.

Kemi dy momente, të cilat duhet, besoj, t'i shohim me kujdes dhe besoj se drafti i paraqitur nga kolegët arrin më së miri që t'i adresojë këto probleme.

Këto probleme vijnë nga të gjithë këto raporte që ju thashë pak më përpara, nga gjithë këto vërejtje që kanë ardhur për procesin apo gjithë kjo vështirësi që është hasur gjatë rrugës së zbatimit të ligjit të vetingut.

Problemi i parë ka të bëjë me rishikimin në tërësi të thellësisë apo mënyrës së shkallës të të bërit të vetingut në trupën e Policisë së Shtetit, ku futet këtu edhe pjesa e shpejtësisë me të cilën duhej bërë apo që parashikonte ligji të bëheshin, por që në fakt, në të vërtetë nuk na rezultoi kështu, me një ushtrim dyvjeçar të bërë deri tani në zbatim të ligjit, pasi vetëm 32 subjekte janë vetuar deri tani, ndërkohë që trupa e Policisë së Shtetit është shumë më e madhe. Problemi tjetër është që ne, gjithsesi, duhet të përgatisim një trupë brenda ekzekutivit, e cila duhet të merret me një proces të vazhdueshëm të verifikimit të figurës sidomos gjatë zhvillimit të karrierës të punonjësit të policisë.

Të dyja këto probleme janë adresuar më së miri në draftin e propozuar nga kolegët, duke bërë të mundur që ne, në radhë të parë, të pezullojmë këtë proces të tejzgjatur që bën komisioni i jashtëm i vlerësimit në lidhje me trupën e policisë dhe komisioni i jashtëm i vlerësimit të fokusohet vetëm në vetingun e një trupe të brendshme që do të merret në të ardhmen me procesin e vetingut. Ndërkohë, t'i lëmë kohë vetes që të shikojmë të gjitha rekomandimet që vijnë nga institucione të ndryshme apo edhe nga vetë komisioni, si monitoruesi, për ta riparë në tërësi nëse duhet të ndryshojmë ndonjë gjë që ka të bëjë me të ardhmen e këtij procesi kaq të rëndësishëm.

Zonja kryetare,

Të dashur kolegë,

Mendoj që propozimi vjen në kohën e duhur dhe është i duhuri për të zgjidhur të dyja këto momente.

E para, ne pezullojmë vetingun për trupën e policisë dhe fokusohemi vetëm te trupa që do të jetë brenda SHÇBA-së dhe, e dyta, i lëmë kohë vetes si politikëbërës, edhe ne si ekzekutiv, por edhe ju si parlament, që ta shikojmë në tërësi në frymën e rekomandimeve që

na vijnë nga të gjitha raportet e parterëve dhe sidomos të institucioneve ku Shqipëria është pjesë dhe që merren me fushën e sigurisë.

Për ta përmbyllur po ju them edhe një herë që si ministër i Brendshëm në emër të qeverisë shpreh dakordësinë e plotë me këtë amendim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër për fjalën tuaj dhe mbështetjen ndaj propozimit të disa kolegëve të Komisionit të Sigurisë për të bërë një ndërhyrje në ligj!

Fjala është për ju, kolegë, për pyetje ose diskutime në mbështetje ose jo të kësaj nisme.

Ndërkohë dua të bëj me dije disa të dhëna që ne i kemi marrë nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat për faktin se sa persona janë vetuar nga ky institucion. Kujtoj që një nga ndryshimet e bëra në ligj ishte që procesi i vetingut të bëhet paralelisht nga komisioni i jashtëm i vlerësimit, që është një trupë e përbërë nga 15 veta, që asistohen nga një sekretariat teknik po me kaq veta, ndërkohë që edhe Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat të fillonte vetimin për pjesën e gradave të mesme dhe të ulëta. Ky ishte ndryshimi i parë dhe themelor që u bë në ligj, veçanërisht në mekanizmin e bërjes së vetingut.

Në fillim kishim një mekanizëm që ishte i përputhur me të ashtuquajturin parim ...(nuk dëgjohet). Pra, të fillonte komisioni i jashtëm i vlerësimit, kishte një komision qendror të vlerësimit dhe mandej hetimi do të bëhej nga komisionet vendore të vetimit. Parashikohej që deri në fund trupa të zgjerohej maksimalisht, me qëllim që t'i përgjigjej edhe numrit të madh të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gradës dhe SHÇBA-së, por që në fillim u pa që ishte i pamundur zbatimi i këtij mekanizmi. Një nga ndërhyrjet e para ishte që komisioni i jashtëm i vlerësimit të vetonte gradat e lata dhe SHÇBA-ja të vazhdonte me vetimin e pjesës tjetër të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Nga kjo trupë janë vetuar nëntë persona, nga të cilët gjashtë e kanë kaluar procesin e vetimit, kurse tre nuk e kanë kaluar dhe për rrjedhojë janë përjashtuar nga radhët e SHÇBA-së. Në proces janë edhe 42 persona. Krahasuar kjo me numrin e përgjithshëm të të vetuarve deri tani nga komisioni i jashtëm i vlerësimit, që është vetëm 32 veta, edhe pse ligji është miratuar që në vitin 2018 dhe në fillimet e tij parashikimet ishin shumë optimiste, të mund të përfundonin brenda dy vjetëve vetimin e 13 mijë vetave, rezultatet janë këto. Na takon ne si ligjvënës që të ndërhyjmë për të siguruar efektivitetin e procesit dhe qëllimin e procesit në mënyrën më të duhur të mundshme.

Kush nga kolegët e do fjalën

Zonja Xhina?

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezencën dhe fjalën tuaj!

Falenderoj të gjithë kolegët e komisionit që kanë formuluar dhe paraqitur këtë amendim në projektligj, pasi ishte tejet i nevojshëm. Ne si komision e kemi ndjekur përherë me shqetësim këtë proces pasi kemi qenë që në fillim bashkë me të dhe me ecurinë e tij, si dhe kemi folur për ndryshime për ndryshimet e herëpashershme që e kanë shoqëruar.

Dua t'ju falenderoj të gjithëve për ndryshimin që keni paraqitur, pasi jam i bindur që ky do të jetë një mekanizëm zhblokues dhe që do t'i japë rrugën e duhur procesit, duke qetësuar në një farë mënyre të gjithë trupën që ka qenë në një farë mënyre në ankth për këtë proces dhe mënyrën se si do të funksiononte procesi. Kështu që, e shikoj si diçka shumë pozitive dhe keni mbështetjen time maksimale.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, kolege!

Kush nga kolegët e tjerë të komisionit e do fjalën.

Zonja Dralo e kërkon fjalën.

Artemis Malo (Dralo) – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Ministër,

Të nderuar kolegë,

Dua thjesht të theksoj se ku është ndryshimi që vjen në përputhje me rekomandimet e partnerëve ndërkombëtarë, të cilët asistojnë çështjet e rendit dhe të sigurisë, por edhe të gjitha problematikat e evidentuara prej tyre, sikurse i referohet edhe vlerësimi i GRECO-s, në të cilin citohet: “Procesi aktual kalimtar i vetingut duhet të zëvendësohet me një mekanizëm për vlerësimin e integritetit të personelit rregullisht gjatë karrierës së tyre dhe për qëllimet e ngritjes në detyrë. Ndërkohë të paktën vetingu kalimtar duhet të përqendrohet në funksionet më të ekspozuara ndaj riskut të integritetit”.

Këto janë rekomandimet e GRECO-s. Konkretisht, një nga pikat më të rëndësishme që duhet theksuar është që kontrolli për integritetin e kandidatëve të kryhet në kontekstin e ndryshimeve të postit dhe ngritjes në detyrë dhe në interval të rregullta gjatë karrierës së punonjësve në polici. Në fakt, duke e vlerësuar procesin e vetingut deri tani duhen vlerësuar dhe marrë parasysh rekomandimet e partnerëve, të cilët kanë propozuar edhe këtë iniciativë ligjore, me qëllim që ky proces të bëhet efektiv, por dhe të garantojë vazhdimësinë e tij pas këtij vlerësimi kalimtar të trupës së vlerësimit të SHÇBA-së.

Unë e përgëzoj këtë iniciativë dhe i ftoj kolegët që të jemi unanimit në këtë mendim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Malo.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Ministër!

Në fakt, unë jam një nga propozuesit së bashku me kolegët e tjerë. Në kushtet kur ministri i Brendshëm pranoi propozimin tonë, zonja kryetare, mendoj që ne duhet ta hedhim në votim.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Nëse nuk ka diskutime të tjera, më lejoni t'ju bëj me dije që, edhe për hir të transparencës së mbledhjes duke qenë se mbledhjet e të gjitha komisioneve parlamentare zhvillohen live, sapo më erdhi një shkresë e komisioni të jashtëm të vlerësimit, e cila mban datën 26 shkurt dhe numër protokollit 47, por në Kuvendin e Shqipërisë hyrja është bërë vetëm ditën e sotme, datë 2 mars 2021.

Sidoqoftë, për aq sa pata mundësi ta shikoj në një pamje të parë këtë shkresë, ajo çfarë kjo shkresë përmban është përditësimi për punën e komisionit të jashtëm të vlerësimit.

Si anëtarë të këtij nënkomisioni dua të vë në dukje që ne jemi njohur në vijim me punën e këtij nënkomisioni. Pra, kemi qenë gjithmonë në kontakt të vazhdueshëm, jemi përditësuar me raporte të ushtrimit të veprimtarisë nga ana e tyre, por ajo që na duhet të pranojmë të gjithë dhe që e kemi pranuar të gjithë është që ky proces nuk ka ecur sipas pritshmërive. Arsyet dhe faktorët janë nga më të ndryshmit. Unë shpresoj që me praktikën e punës së akumuluar në më shumë se 1 vit ose gati 2 vjet të këtij komisioni këta anëtarë të këtij nënkomisioni të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ju ngarkon ligji dhe, sipas propozimit që ne kemi bërë, të mund të votojnë në kohë trupën vlerësuese të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Ndërkohë, mendoj që ndoshta më vonë do të kemi të gjithë tablonë e qartë të ndryshimeve të tjera që mund të duhen për të adresuar përfundimisht këtë problematikë me të cilën jemi ndeshur gjatë kësaj kohe.

Kalojmë në votimin e nismës.

Kush është dakord me nismën “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gradës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”? Faleminderit! Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe Gradës së Republikës pezullohet deri në përfundimin e procesit të vlerësimit kalimtar të trupës së

vlerësimit të punonjësve të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Pro? Kundër dhe abstenim nuk ka.

Miratohet.

Ndërkohë, neni 2 ka të bëjë me hyrjen në fuqi të këtij ligji, hyrja në fuqi e këtij ndryshimi, në fakt, ligjor që ne kemi propozuar, parashikohet të jetë në afatin e zakonshëm: 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord me këtë ndryshim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, u lutem edhe kolegëve që nuk i kam me figurë për miratimin në tërësi të projektit. Kush është dakord me miratimin në tërësi të ndryshimit të propozuar në ligjin “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe të SHÇBA-së”?

Po, faleminderit. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Bledar Çuçi – Kryetare, të lutem, një ndërhyrje të vogël.

Vetëm se nuk pashë atje, kam merak për dosjet që janë *ongoing*, domethënë të cilësohet që të pezullohen ato dosje që janë në proces. Domethënë, nuk e di nga ana e teknikës legislative nëse presupozohet që ato pezullohen automatikisht. Pra, nuk e di, ndoshta mund të jetë një interpretim i tillë, por do të doja që edhe dosjet që janë në proces të pezullohen për sa i takon trupës së policisë dhe të fillohet të merren vetëm me vetingun e trupës së SHÇBA-së.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër!

Mendoj që dispozita e përmban qartësisht këtë gjë, pasi kërkon pezullimin e procesit dhe vijimin vetëm me SHÇBA-në. Kështu që jemi të qartë.

Atëherë, miratohet nisma.

Faleminderit, zoti Ministër, për prezencën tuaj!

Sigurisht, jeni i lirë të vijoni me pjesën tjetër të angazhimeve tuaja.

Ndërkohë, u lutem kolegëve të qëndrojnë për vazhdimin e diskutimit të një projektligji po aq të rëndësishëm për të bërë së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme dhe Gardës së Republikës ligjin e ri që kërkojmë t’i japim Gardës së Republikës.

Është bërë një punë, natyrisht, nga ana e relatores dhe e përfaqësuesve të Gardës dhe të Ministrisë së Brendshme për të arritur dakordësinë për disa nene për të cilat kishim propozime alternative nga ana e Gardës së Republikës. Kështu që unë mendoj që do të procedojmë në kohë reale, meqenëse kjo dakordësi tashmë është arritur falë bashkëpunimit me grupin e punës.

Sekretar

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretare e komisionit

Rashela Lalaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.3.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen i projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”
(*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Artemis Malo, Elona Hoxha Gjebrea, Antoneta Dhima, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Lefter Maliqi, Ylli Shehu, Edmond Rrushi, Arben Elezi, Nimet Musai dhe Adnor Shameti

Mungojnë:

Alban Zeneli, Xhemal Qefalia, Paulin Sterkaj, Anduel Xhindi, Luan Duzha, Luan Harusha, Myslim Murrizi, Edmond Stojku

Të ftuar:

Julian Hodaj – Zëvendësministër i Brendshëm

Elena Pici – Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Brendshme

Fatmir Shehu – Drejtor Juridik në Ministrinë e Brendshme

Ermonela Felaj – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi nen për nen i projektligjit të ri “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”.

Fillojmë me nenin 1 të këtij projektligji, ku përcaktohet objekti i ligjit që ka të bëjë me misionin, me organizimin, me funksionimin, detyrat, të drejtat dhe statusin e Gardës së Republikës. Natyrisht, objekt i ligjit është edhe rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe vazhdimësisë në detyrë të punonjësve të Gardës së Republikës.

Ka vërejtje ose sugjerime për nenin 1?

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2 ka të bëjë me misionin, pra cili është misioni i Gardës së Republikës dhe misioni, natyrisht, është i njohur që ka të bëjë me garantimin e sigurisë së personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje; mision që ngelet i pandryshueshëm edhe në rastet e forcës madhore.

Ka vërejtje ose sugjerime? Do t’ju lutesha që ta kishim edhe relatoren në të njëjtën figurë, me qëllim që në çdo rast zonja Malo të ndërhynte.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 ka të bëjë me statusin e Gardës së Republikës, e cila parashikohet të jetë institucioni i administratës shtetërore, person juridik në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe të sigurisë publike.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 4 “Parimet e veprimtarisë” që fillon me parimin e ligjshmërisë dhe përfundon me parimin e kontrollit dhe llogaridhënies.

Ka vërejtje ose sugjerime për këtë nen? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 ka të bëjë me përkufizimet e termave, të cilët i hasim në përmbajtje të ligjit, duke filluar me “armatimin dhe pajisjet personale” dhe duke shkuar deri në fund të çdo termi që ne shohim në ligj.

Ka diskutim nga kolegët në lidhje me këtë nen? Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

I vetmi propozim që do të bëja, nëse ju e shihni me vend, do të ishte që lidhur me pikat 22 dhe 23, ku flitet për...

Ermonela Felaj – Keni probleme me foninë.

Elena Xhina – Institucionin që i lëshon këto dokumente.

Ermonela Felaj – A mund ta përsërisni, ju lutem, se pati një shkëputje, ndoshta nuk e kuptuan të gjithë fjalën tuaj?

Elena Xhina – Më falni?

Ermonela Felaj – A mund ta përsërisni edhe një herë, se patëm një shkëputje të zërit tuaj? Nuk e kuptuam dot të gjithën.

Elena Xhina – Dëgjohem?

Ermonela Felaj – Atëherë, duhet të logoheni edhe një herë në sistem që të mund t'ju dëgjojmë.

Elena, dëgjohe mi?

Elena Xhina – Ndjesë, nuk e di pse pata një shkëputje.

Ermonela Felaj – Tani ju dëgjojmë. Kështu që mund ta përsërisni edhe një herë ndërhyrjen tuaj.

Elena Xhina – Atëherë, unë do të propozoja që për sa u përket pikave 22 dhe 23, ku flitet për vërtetimin e besueshmërisë dhe verifikimit të pastërtisë së figurës së punonjësit, nëse do të ishte e mundur, të vendosej edhe institucioni që e lëshon; thjesht për qartësi të dispozitës që të mos e përsërisim më vonë gjatë projektligjit.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit.

Fjalën mund ta marrë relatorja dhe kolegët, në qoftë se kanë ndonjë opinion për propozimin e bërë nga kolegja.

Artemis Malo – Në fakt, sugjeroni që të citohet konkretisht në pikat 22 dhe 23?

Ermonela Felaj – Institucioni.

Artemis Malo – Të citohet institucioni, kjo është ajo që ju sugjeroni?

Elena Xhina – Po nga i cili lëshohen këto dy akte.

Artemis Malo – Po.

Elena Xhina – Sepse kur unë e lexova, nuk e dija, për shembull, se nga kush lëshoheshin këto akte, nga cili institucion dhe ia shtrova pyetje zotit Hodaj herën e kaluar, për të qenë edhe më e qartë.

Artemis Malo – Mirë.

Ermonela Felaj – Kush e do fjalën nga ju, zoti Hodaj, apo drejtori juridik?

Julian Hodaj – A mund të flas unë, zonja kryetare?

Ermonela Felaj – Patjetër, zoti Hodaj.

Julian Hoda – Unë jam dakord, në qoftë se duhet ta qartësojmë për hir të tekstit, se nganjëherë për ne duket kollaj. Vërtetimi i besueshmërisë është një dokument që lëshohet nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, sepse është i vetmi institucion që ka databazat e nevojshme për ta kryer këtë lloj procesi dhe e kryen sot për të gjithë ata, të cilët i nënshtrohen një procesi të besueshmërisë edhe kur vjen puna për certifikatat e sigurisë.

Ndërsa, kur flasim për verifikim të pastërtisë së figurës, ky vlerësimi periodik, tashmë edhe mbi bazën e ligjit që ju në pikën e parë sapo amenduat, është një proces që i takon SHÇBA-së në rastet kur ligji nr. 108/2018 e parashikon.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Vetëm se pyetja është: a e gjeni me vend që të shkruhet në ligj se prej cilit organ?

Julian Hodaj – Këtë e lëmë si ta çmoni ju. Në gjykimin tonë, kjo rrethanë kuptohet mjaftueshëm. Por, nëse do të duam ta shtojmë, për ne nuk ka asnjëlloj problemi.

Ermonela Felaj – Mirë, faleminderit!

Opinione të tjera nga kolegët? Atëherë, më lejoni të shpreh edhe opinionin tim.

Besoj që në kushtet, në të cilat, në fakt, ne jemi duke pasur në diskutim edhe një projektligj tjetër, që është ai i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe, sigurisht, është pak herët për të thënë se cila do të jetë përmbajtja përfundimtare e këtij projekti, sepse na duhet që ta diskutojmë projektin dhe në këtë moment jemi në proces konsultimi me disa sa institucione.

Unë do të gjykoja që ndoshta nuk do të ishte momenti i duhur që në përmbajtje të këtij ligji, që është ligj për gardën, të përcaktonim institucionin që lëshon vërtetimin, sepse është diçka që do të definohet siç duhet edhe në këtë ligj, edhe në qëndrimin që ne do të kemi më pas, pasi sapo diskutuam edhe për ligjin e vetingut në radhët e Policisë së Shtetit dhe do të shohim si do të ecë tanimë ky proces nga punonjësit e SHÇBA-së. Kështu që, nuk e di, do të desha edhe mirëkuptimin tuaj, zonja Xhina, në mënyrë që të mos bëjmë asgjë të gabuar, e cila pastaj të na detyrojë t'i rikthehemi ligjit me një ndërhyrje.

Ideja e dokumentit është dhënë qartë në përmbajtje. Pastaj, besoj që detyrimi përcaktohet në ligjet e organeve që do të ngarkohen me këtë detyrë.

Elena Xhina – Mundem?

Ermonela Felaj – Po, faleminderit!

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, lidhur me pikën 23 keni shumë të drejtë, sepse mund të pësojë ndryshime të herëpashershme. Megjithatë, ideja ishte thjesht për ta bërë sa më të qartë ligjin, por nuk... *(Nuk dëgjohet.)*

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina, për mirëkuptimin!

Atëherë, kolegë, kush është dakord me përmbajtjen e nenit 5, siç është propozuar?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 6, që ka të bëjë me organizimin e Gardës së Republikës dhe, natyrisht, garda është një institucion që do të organizohet në struktura hierarkike, në nivel drejtorie të përgjithshme, departamenti, drejtorie, sektori dhe seksioni.

Ka ndërhyrje për këtë nen? Po, zonja Malo.

Artemis Malo – Po, ka një ndërhyrje. Kemi dakordësuar me Ministrinë e Brendshme dhe me gardën, gjithashtu, që do të shtohet në nen edhe zëvendësdrejtori i Përgjithshëm. Kemi parashikuar edhe një dispozitë për këtë nivel për kriteret, e cila mund të shtohet pas nenit 17 që do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

“Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm”:

1 - “Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbështetet nga dy zëvendësdrejtorë të Përgjithshëm.

2 - Zëvendësdrejtorët kryejnë detyrat që i caktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës.

3-Zëvendësdrejtorët emërohen nga ministri, nga punonjësit e Gardës, që mbajnë gradën drejtues i parë, dhe i jepet grada drejtues i lartë, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës.

4-Ministri cakton një nga zëvendësdrejtorët, që të ushtrojnë kompetencat dhe detyrat e drejtorit, në rastet kur drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk është emëruar ende; në rast paaftësie apo pezullim nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës.

5- Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm të Gardës së Republikës nuk mund të ushtrojë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë më shumë se gjashtë muaj.

Kjo është ndërhyrja që kemi bërë.

Ermonela Felaj – Atëherë, më lejoni të saktësoj: përmbajtja që ju lexuat, është përmbajtja e nenit 6, që ju keni propozuar në grupin e përkohshëm?

Artemis Malo – Do të shtohet. Pra, është një koment, i cili mund të shtohet pas nenit 17, me këtë përmbajtje.

Ermonela Felaj – Po neni 6, do të qëndrojë siç është?

Artemis Malo – Do të ndryshojë. Pra, Garda organizohet në struktura hierarkike, në nivel Drejtorie të Përgjithshme, zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, drejtorie seksioni e seksioni.

Ermonela Felaj – Pra, jemi te departamenti.

Artemis Malo – Po.

Ermonela Felaj – Pika 2 qëndron siç është? Struktura, organika dhe numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Artemis Malo – Po.

Ermonela Felaj – Në rregull! Përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, ju lutem!

Julian Hodaj – Kryetare, kemi një ndryshim në raport me variantin që keni përpara, dhe kemi rënë dakord, por gjatë orës së fundit, duhet të them: struktura dhe organika miratohen me urdhër të ministrit.

Sepse, për numrin e përgjithshëm, mendoj se mund të lihet kështu siç është, por numri i përgjithshëm i Gardës së Republikës shkon për buxhetin zakonisht, vit për vit, kështu që nuk përbën problem. Ndërsa në lidhje me strukturat organike, propozimi ynë është që të miratohen me urdhër të ministrit. Kjo sepse kemi një drejtor të Përgjithshëm, të cilin e emëron Kryeministri, ndaj nuk ka kuptim që strukturën organike ta çojmë në një nivel më sipër.

Kjo duhet të jetë te varianti i fundit, që ju ka ardhur pak përpara. Ju kërkohet ndjesë për problemin e kohës, por ky është propozimi ynë i fundit, në lidhje me të cilin kemi gjetur edhe dakordësi.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Atëherë do të më duhet ta përmbledh...

Julian Hodaj – Ju lutem, edhe një herë, që ta sqaroj: struktura dhe organika miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës.

Ermonela Felaj – Me urdhër të ministrit të Brendshëm.

Julian Hodaj – Po, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës.

Ermonela Felaj – Atëherë, përmbajtja e nenit 6, që propozohet nga grupi i punës, edhe për rekordet e zbardhjes finale, do të jetë kjo: garda organizohet për struktura hierarkike në nivel Drejtorie të Përgjithshme, zëvendës drejtori të Përgjithshëm, drejtorie, sektori e seksioni.

A jemi dakord me pikën ‘i’?

Zonjën Malo e kam në krah, por ndërkohë do të doja edhe pohimin tuaj.

Pika e dytë: “Numri i përgjithshëm i punonjësve të Gardës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”. Ndërkohë, pika e tretë do të jetë: “Struktura dhe organika miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës”.

Julian Hodaj – Zonja kryetare, në kuptimin tuaj, pika duhet të rrijë. Sepse ju thashë, në çdo fund viti propozojmë numrat dhe buxhetet për çdo institucion varësie, që kalon te ligji i buxhetit. Kësisoj, nuk e di nëse është e udhës të parashikojmë një VKM të veçantë vetëm për numrin e punonjësve të Gardës së Republikës. Pra, kemi mundësi ta ndërrojmë edhe atje.

Ermonela Felaj – A propozoni për çdo institucion që është në varësinë tuaj numri?

Julian Hodaj – Këtë e bëjmë në kuadër të ligjit për buxhetin.

Ermonela Felaj – Për të gjitha dakord. Garda e Republikës është institucion në varësinë tuaj.

Julian Hodaj – Qartë.

Ermonela Felaj – Kjo bën sens, që ju ta propozoni dhe ai të miratohet me VKM.

Julian Hodaj – Është kjo që ndodh praktikisht, por në qoftë se kjo rri këtu, do ta kemi të parashikuar në dy ligje, prandaj. Thjesht në gjykimin tuaj, sepse nuk përbën problem për ne.

Ermonela Felaj – Mirë me thelbin e gjërave, me mënyrën se si organizohet, që të kemi një drejtor të Përgjithshëm, zëvendës drejtor të Përgjithshëm, por edhe drejtori, sektorë e seksione. Po me pjesën tjetër, kemi ndonjë diskutim nga ana e kolegëve? Nuk kemi.

Atëherë, kush është dakord me përmbajtjen e propozuar për nenin 6?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni tjetër, neni 7 i ligjit.

Neni 7 i ligjit ka të bëjë me detyrat e Gardës së Republikës. Në ligj parashikohen disa nga detyrat e Gardës.

Kemi komente në lidhje me këtë nen, nga kolegët, nga relatorja apo nga përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme?

Unë do të kisha vetëm një propozim të natyrës gjuhësore kudo në përmbajtjen e ligjit, ku përmendet fjala “ambient”, që mendoj se duhet të zëvendësohet me fjalën shqipe “mjedis”.

Kjo është gjëja që kam kapur me shikim të parë, ndaj besoj se duhet ta korrigjojmë këtë. Për pjesën tjetër të detyrave nuk ka pasur vërejtje në lidhje me propozimin për përmbajtjen e nenit 7.

Atëherë, kush është dakord me nenin 7?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8 i ligjit. Neni 8 ka të bëjë me nivelet e gatishmërisë së Gardës. Pra, garda e kryen veprimtarinë e saj duke u organizuar disa nivele gatishmërie:

-Niveli i gatishmërisë normale, jeshile.

Këtu do të propozoja që fjala jeshile të zëvendësohet me fjalën e gjelbër.

-Niveli i gatishmërisë së përforcuar, portokallí.

-Niveli i gatishmërisë së lartë, e kuqe.

Këto janë nivelet, me të cilat vepron Garda e Republikës për ushtrimin e funksioneve të saj.

A kemi propozime a sugjerime në lidhje me këtë nen?

Artemis Malo – Jo.

Ermonela Felaj – Relatorja jo. Po nga ana e ministrisë, a jemi dakord me përmbajtjen?

Nuk kemi qëndrime të reja.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 9, i cili ka të bëjë me bashkëpunimin. Pra, Garda e Republikës, në përmbushje të misionit të saj, bashkëpunon me Policinë e Shtetit, me Shërbimin Informativ, me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, me Protokollin e Shtetit, me Administratën e Institucionit të Presidentit...

Ju lutem, këtë duhet ta shkruajmë të plotë: Administratën e Institucionit të Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, protokolleve dhe kabineteve të institucioneve të tjera.

Sigurisht, ka edhe disa ente të tjera publike, por jo vetëm, të cilat detyrohen të bashkëpunojnë me Gardën e Republikës.

Nuk ka vërejtje e sugjerime të depozituara në lidhje me këtë nen.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 9!

Kalojmë te neni 10: “Detyrime për subjektet shtetërore dhe private”.

Ka një ndërhyrje nga ana e relatores, për nenin 10 të projektit.

Artemis Malo – Ka një ndryshim te pika 4. Pikat 1, 2 dhe 3 i kemi ashtu siç është propozuar varianti. Te pika 4 duhet hequr togfjalëshi: “kur aktiviteti i personaliteteve lidhet me institucionet shtetërore”.

Ermonela Felaj – Pra, a mund ta lexojmë edhe një herë përmbajtjen e pikës 4 të këtij neni?

Artemis Malo – “Të gjitha institucionet shtetërore detyrohen t’i japin menjëherë Gardës çdo informacion të mundshëm, që rrezikon sigurinë e personaliteteve dhe të objekteve në ruajtje, sipas këtij ligji.”

Ermonela Felaj – Atëherë, është propozuar që në pikën 4 të hiqet një shprehje, që është: “kur aktiviteti i personaliteteve lidhet me institucionet shtetërore”.

Pra, kjo që të mos kushtëzohet dhënia e informacionit Gardës së Republikës, thjesht e vetëm me faktin kur personaliteti, që Garda detyrohet të ruajë, hyn në një institucion shtetëror sepse aktiviteti që ai do të zhvillojë ka lidhje pikërisht me atë institucion, por në çdo rast Garda të ketë të drejtën të marrë çdo informacion të mundshëm në lidhje me sigurinë e personalitetit.

Ka ndonjë diskutim nga kolegët, në lidhje me këtë nen?

Pika 1- “Protokolli i Shtetit dhe kabinetet e institucioneve ku ushtrojnë veprimtarinë personalitetet, do ta njoftojnë Gardën e Republikës në lidhje me kohën dhe vendin e zhvillimit të aktivitetit sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 24 orë para fillimit të tij, në mënyrë që Garda të marrë masat e nevojshme për mbrojtje.

Pika 2 - Strukturat shtetërore që ofrojnë shërbimin e urgjencës dhe të kujdesit parësor për personalitetet e larta të shtetit, dhe struktura që ka përgjegjësi për mirëqenien sociale të tyre, detyrohen të bëjnë verifikimin e besueshmërisë.

Pika 3 - Personat fizikë dhe juridikë, shtetërorë apo privatë, janë të detyruar të mos pengojnë punonjësit e Gardës në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e personaliteteve të vendit dhe të huaja, në rastet kur është i nevojshëm përdorimi i mjediseve në administrim apo në pronësi të tyre. Procedurat për kryerjen e veprimeve në mjediset në administrim apo në pronësi të persona fizikë ose juridikë, shtetëror apo privat, përcaktohen në rregulloren e Gardës.

Pika 4: Të gjitha institucionet shtetërore detyrohen t’i japin menjëherë Gardës çdo informacion të mundshëm, që rrezikon sigurinë e personaliteteve, të objekteve në ruajtje, sipas këtij ligji.”

Kështu propozohet të jetë përmbajtja e këtij neni.

Ka ndonjë diskutim nga ana e ministrisë?

Zoti Hodaj, një pyetje: pse ishte e nevojshme të hiqej shprehja: “kur aktiviteti i personaliteteve lidhet me institucione shtetërore”. Kjo ka qenë shprehja e propozuar.

Julian Hodaj – E thatë ju, zonja kryetare, dhe bie dakord me atë që thatë. Ideja është që çdo institucion shtetëror, i cili ka një informacion që mund të vërë në rrezik një personalitet, duhet patjetër ta vërë në dispozicion, e jo thjesht pse ka lidhje me veprimtarinë e atij institucioni.

Ermonela Felaj – Në rregull!

Julian Hodaj – Pra, i hapim rrugën mundësisë që Garda të mbledhë e të krijojë edhe njësinë e vet të inteligjencës, si dhe të ketë mundësi që t'i kryejë detyrat në mënyrën më efektive të mundshme.

Ermonela Felaj – Në rregull! Pyetjen e bëra me qëllim që edhe të gjithë kolegët të ishin të qartë.

Atëherë, ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 10 ashtu siç u lexua?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 11, i cili ka të bëjë me kufizimet që kanë punonjësit e Gardës. Natyrisht, punonjësve të Gardës u ndalohet anëtarësimi, pjesëmarrja në veprimtari politike, pjesëmarrja në manifestime dhe në grevë.

Kush është dakord me këtë nen?

Po, faleminderit!

Kundër? Abstenime? Nuk ka.

Miratohet!

Kalojmë në nenin 12 “Personalitetet dhe objektet që ruhen e mbrohen nga Garda e Republikës” dhe kemi një listë të personaliteteve, për të cilët Garda merr një detyrim të tillë. Ka diskutime nga grupi i punës për këtë nen?

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 13 “Ruajtja e personaliteteve pas lënies së detyrës”. Është fakt që për personalitetet e larta shtetërore, edhe pasi lënë detyrën, u lihet një afat kohe i përcaktuar në ligj, që varion sipas peshës dhe rëndësisë së funksionit, të vijojnë mbrohen nga Garda e Republikës. Presidenti i Republikës e ka 5 vjet afatin e mbrojtjes pas mbarimit të mandatit, Kryetari i Kuvendit e ka 4 vjet dhe Kryeministri 4 vjet. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 14 “Kohëzgjatja e ruajtjes së objekteve”. Është vijimi i asaj që folëm më lart. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu IV “Autoritetet dhe përgjegjësitë”, neni 15 “Ministri”, përgjegjësitë dhe kompetencat e ministrit për Rendin dhe Sigurinë Publike.

Artemis Malo - Ka një ndërhyrje te germa “e”. Pasi është dakordësuar me Gardën, sipas propozimit të saj, të mbahet varianti i Ministrisë së Brendshme, konkretisht: “Emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës me gradën “Drejtues i Lartë” me propozim të drejtorit të Përgjithshëm”. Ky është propozimi, me të cilin është dakordësuar për këtë ndryshim.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Zoti Hodaj, fjala për ju.

Juljan Hodaj - Gjithashtu, hiqet edhe germa “ë”, “Propozon strukturën dhe organikën”, sepse e bëmë ndryshimin te neni më lart.

Ermonela Felaj- Atëherë, sipas propozimit tuaj, germa “ë” bie.

Ju lutem, ma lexoni edhe një herë germën “e”.

Juljan Hodaj- “Emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës me gradën “Drejtues i Lartë”, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës”.

Ermonela Felaj- A ka diçka nga kolegët? Jo, nuk ka. Kush është dakord me ndryshimet e propozuara në nenin 15, që germa “e” riformulohet, siç u citua, dhe germa “ë” hiqet nga përmbajtja e ligjit? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 16 “Drejtori i Përgjithshëm”, bëhet fjalë për drejtorin e Përgjithshëm të Gardës. Zonja Malo, keni ndërhyrje?

Artemis Malo- Po. Ndryshimi është te germa “e”: “Emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës, me përjashtim të gradës “Drejtues i Lartë”.

Ermonela Felaj- Dakord, kjo i shkon edhe ndryshimit që bëmë te kompetencat e ministrit. Zoti Hodaj, a e konfirmoni nevojën e këtij ndryshimi?

Juljan Hodaj- Po. Në gjykimin tim, nuk ka nevojë as ta shtojmë, sepse procesi i gradave që fitohen është i rregulluar në ligj, pra, nga “Inspektor” deri “Drejtues i parë”, por që emërimin formal patjetër që do ta bëjë....

Ermonela Felaj- Meqenëse flitet për drejtorin dhe detyrat e tij në përgjithësi, besoj se duhet të përmenden të gjitha.

Juljan Hodaj- Unë sugjeroj që te germa “b” të heqim fjalët “Pasurinë e Gardës”, sepse kur themi që menaxhon burimet njerëzore dhe financiare, praktikisht, i kemi të përfshira aty.

Ermonela Felaj- A mund ta bëjmë: “Menaxhon burimet njerëzore dhe asetet financiare të Gardës?”

Juljan Hodaj- Mjafton të themi: “Burimet njerëzore dhe financiare të Gardës” dhe mbulojmë çdo hipotezë të mundshme.

Ermonela Felaj – A ka ndërhyrje nga kolegët për propozimin për germën “b” që teksti nga “Menaxhon burimet njerëzore dhe asetet financiare të Gardës” të bëhet “Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të Gardës”? Megjithëse, mua, personalisht togfjalëshi “Burim financiar i Gardës” më vë në dyshim dhe do të isha dakord të thuhej: “Asetet financiare të Gardës”, sepse “Burime financiare” duket sikur Garda financohet nga ndonjë ent jashtë buxhetit të shtetit ndërkohë që Garda financohet nga buxheti i shtetit. Kolegë, dua ndihmën tuaj për të qenë korrektë me këtë përmbajtje dhe propozohet që germa “e” të ndryshojë sa i takon emërimit, të drejtës për të emëruar nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Gardës: “Emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës, me përjashtim të gradës “Drejtues i Lartë” ”.

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima- Kryetare, unë mendoj që duhet të jetë siç u propozua nga zëvendësministri i Brendshëm, pasi “Asetet financiare” mendohet thjesht ndërtesa, ndërsa kur shprehet ana financiare është në rregull me propozimin e zëvendësministrit të Brendshëm.

Ermonela Felaj- Atëherë, propozimi i koleges Dhima, që është në mbështetje të propozimit fillestar të zotit Hodaj është: “Menaxhon burimet njerëzore dhe financiare të Gardës”, ndërsa germa “e”: “Emëron dhe jep grada për personelin e Gardës së Republikës, me përjashtim të gradës “Drejtues i Lartë”. A ka vërejtje apo sugjerime për diskutimet lidhur me këtë nen? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord që neni 16 ta miratojmë me këto ndërhyrje? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 17 “Kriteret e emërimit të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës”. “Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës emërohet nga Kryeministri me propozim të ministrit dhe i jepet grada “Drejtues madhor”. Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës duhet të plotësojë këto kritere: të ketë vetëm shtetësinë shqiptare; të jetë punonjës i Gardës, që mban gradën “Drejtues i parë” ose “Drejtues i lartë”; të mos ketë masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 vjetëve të fundit dhe të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës.

Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës qëndron në detyrë për një periudhë prej 5 vjetësh me të drejtë riemërimi edhe për 5 vjet të tjera”. A ka diskutime lidhur me këtë nen, megjithëse unë mendoj se ruan mënyrën aktuale të funksionimit të Gardës së Republikës? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 17? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtorit të Përgjithshëm”. “Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës lirohet nga detyra me urdhër të Kryeministrit me propozim të ministrit”. Në ligj parashikohen edhe rastet kur ndodh lirimi nga detyra i drejtorit të Përgjithshëm, por edhe kur ndodh shkarkimi, duke bërë një diferencë midis rasteve të lirimit dhe rasteve të shkarkimit. A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu V “Pranimi, formimi dhe ecuria në karrierë”, neni 19 “Marrëdhëniet e punës”. “Marrëdhëniet e punës në Gardën e Republikës bazohen në parimet e mundësive të barabarta, të meritokracisë dhe mosdiskriminimit. Pranimi në Gardë kryhet nëpërmjet procesit të konkurrimit të hapur”. A ka diskutime për këtë nen?

Juljan Hoda- Përpara se të miratojmë nenin 19, komisioni ndoshta duhet të votojë atë që tha relatorja për zëvendës drejtorin, që ta kompletojmë. Ne e kemi çuar të zbardhur nenin siç e keni përpara, por besoj se edhe rastet e emërimit të zëvendës drejtorit duhen parashikuar pas këtij neni, domethënë pa kaluar të funksionet e tjera.

Ermonela Felaj- Dakord.

Për nenin 19 a ka vërejtje? Nuk ka.

Kush është dakord me nenin 19? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ndërhyrja që u bë pak më herët ishte që në përmbajtje të ligjit të shtohet një dispozitë e veçantë, që i referohet zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Gardës, sepse pranuan që të jetë pjesë e strukturës së Gardës dhe, normalisht, ky nen, ose kjo dispozitë, e ardhur pas dispozitave, ku flitet për drejtorin e Përgjithshëm të Gardës, për kriteret e emërimit dhe për lirimin e shkarkimin e tij nga detyra, duhet të vijë menjëherë pas nenit 18, i cili duhet të vijë si një nen i ri, ku flitet për zëvendës drejtorin e Përgjithshëm të Gardës së Republikës dhe, normalisht, futja e këtij neni të ri do të ndryshojë edhe numërtimin e neneve pasardhëse të ligjit.

Kështu që unë do ju lutesha këshilltarëve të Komisionit të Sigurisë që në zbardhjen përfundimtare të ligjit të kujdesen për të bërë numërtimin e duhur. Ndërkohë, edhe për lehtësi pune, më duhet që të ec me nenet aktuale të projektligjit që kemi të depozituar.

Dakord, kolegë, që të mos ngatërrohemi edhe me numrat? Por gjykoj se duhet patjetër që zëvendës drejtori i Përgjithshëm të parashikohet në një dispozitë konkrete dhe jo me fraksion në ligjin e Gardës së Republikës.

Zonja Xhina, a jemi dakord kështu? Në rregull.

Faleminderit!

Po e lexoj dispozitën e propozuar për zëvendës drejtorin e Përgjithshëm: “Drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës gjatë ushtrimit të kompetencave të tij mbështet nga dy zëvendës drejtorë të Përgjithshëm. Zëvendës drejtorët kryejnë detyrat që caktohen nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës. Zëvendës drejtorët emërohen nga ministri nga punonjës të gardës që mbajnë gradën drejtues të parë dhe u jepet grada drejtues i lartë me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të gardës. Ministri cakton një nga zëvendës drejtorët të ushtrojë kompetencat dhe detyrat e drejtorit kur:

- a. Drejtori i Përgjithshëm i Gardës nuk është emëruar ende.
- b. Në rast paaftësie ose pezullimi nga detyra të drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës”.

Pika 5: “Zëvendës drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës nuk mund t’i ushtrojë kompetencat e drejtorit për një periudhë të pandërprerë më shumë se 6 muaj. E vetmja gjë që do të kisha si një lloj kujtese ose si një lloj tërheqjeje vëmendjeje në momentin e zbardhjes së ligjit do të ishte të ruanim numrin, ose do të flasim në numrin njëjës ose do të flasim në numrin shumës që ta kuptojmë.

Urdhëroni, zoti Hodaj!

Julian Hodaj – Zonja kryetare, unë jam dakord me ju, por do të preferoja që të flasim në numrin njëjës dhe t’ia lëmë strukturës të vendosë sa zëvendës drejtorë të përgjithshëm duhen, duke specifikuar që zëvendës drejtorët janë drejtues të lartë dhe duke specifikuar mundësisht për të shtuar një pikë në fund, ku edhe drejtorët e drejtorive janë drejtues të lartë që mos t’ia lëmë strukturës këtë, por ta sanksionojmë që në ligj.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Julian Hodaj – Ju po punoni mbi atë që kemi punuar dje, por sot kemi pasur një variant të ri dhe jemi dakordësuar me këtë pjesë edhe me relatorët. Do të keni mundësi ta shikoni, ose ne do t’jua dërgojmë sërish versionin e plotë të këtij neni, por logjika është kjo: nuk e përcaktojmë numrin e zëvendës drejtorëve, sepse e lëmë ta përcaktojnë te struktura dhe përcaktojmë që drejtorët e drejtorive janë drejtues të lartë. Kjo siguron që ministri të bëjë të njëjtën gjë që të ketë të njëjtën kompetencë që ka edhe në raport me Policinë e Shtetit, ku i

gjithë niveli drejtues poshtë drejtorit të Përgjithshëm emërohet nga ministri dhe kanë këtë gradë.

Ermonela Felaj – A ka ndonjë gjë tjetër?

Faleminderit për sqarimet, zoti Hodaj!

Kalojmë te neni 20 i projektligjit “Kriteret e pranimit”.

“Kriteret e përgjithshme të pranimit në gardë janë: të jenë shtetas të shqiptar; të ketë zotësi të plotë për të vepruar, të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë; të ketë mbaruar arsimin e mesëm; të jetë i moshës 19 deri 30 vjeç; të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbimin në struktura (sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë); të mos jetë i dënues me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë përjashtuar apo larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore; të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Pra, këto janë kriteret bazë që duhet t’i përmbushë dikush që kërkon të bëhet pjesëtar i Gardës së Republikës.

Zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Te varianti që unë kam përpara, te pika “ç”, thuhet “të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur” s’e di si qëndron kjo te varianti juaj, apo jo?

Ermonela Felaj – Po, më ka kaluar mua pa lexuar, por, në fakt, është e përcaktuar si germa “ç”: “Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur”.

Elena Xhina – Në fakt, unë nuk e kuptoj qëllimin e vendosjes së kësaj sepse, kur themi të ketë përfunduar arsimin e mesëm, si mund të mos dijë gjuhën shqipe në të shkruar dhe në folur, sepse më duket pak kontradiktore. Nuk e di se cili ka qenë qëllimi i kësaj pike, në qoftë se mund të kem ndonjë shpjegim? Nuk di që mund ta përfundosh shkollën e mesme, pa ditur gjuhën shqipe.

Ermonela Felaj – Ideja është ndoshta kur përfundon shkollën e mesme jashtë vendit dhe më pas njëson dëftesën e përfundimit të shkollës së mesme në Shqipëri?

Elena Xhina - Po me çfarë certifikojmë...

Ermonela Felaj – Ne kemi këtu përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme që mund të na japin një shpjegim?

Elena Xhina – Me çfarë dokumenti do të provojë që zotëron gjuhën shqipe të folur dhe të shkruar? Cili është akti që provon që shtetasi zotëron gjuhën shqipe?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Ideja është se mund të ketë edhe shtetas të huaj që kanë fituar shtetësinë dhe që kanë njësuar diplomën. Por se si vërtetohet në praktikë, është ose nga një provim i gjuhës shqipe që e organizon Ministria e Arsimit ose nëpërmjet testit që çdo kandidat detyrohet të bëjë, sipas sistemit të ri të rekrutimit që është parashikuar në këtë ligj.

Ermonela Felaj – Në pikën 4 të këtij neni thuhet: “Pranohen si punonjës të Gardës së Republikës edhe shtetasit që kanë përfunduar arsimin përkatës në institucionet arsimore homologe jashtë vendit dhe të njësuara me programet e institucionit arsimor të Policisë së Shtetit, xhandarmërisë, karabinierisë dhe gardës civile apo strukturave të tjera të njësuara me to dhe diplomat e tyre janë njohur dhe janë ekuivalentuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.”.

Edhe dikush që ka shtetësinë shqiptare dhe ka përfunduar arsimin jashtë, mund të bëhet pjesë e Gardës së Republikës dhe të lidhura bashkë besoj se shkon kushti i zotërimit të gjuhës shqipe të shkruar dhe të folur.

Julian Hodaj – Nuk besoj se ka nevojë për shpjegim, por besoj se jemi të hapur...

Ermonela Felaj – Kini parasysh që te ligji për shtetësinë që të fitosh shtetësinë shqiptare duhet ta dish gjuhën shqipe dhe aty flitet për mënyrën se si provohet njohuria e gjuhës shqipe e shkruar dhe e folur.

Julian Hodaj – Zonja kryetare, pika 4 që ju përmendët, ka tjetër funksion. Pika 4 i hap rrugën faktit që gjithkush, që shkollohet jashtë shtetit në një nga këto institucionet e homologe dhe që ndjekin, pak a shumë, të njëjtat programet mësimore, si Akademia e Sigurisë, të mos ketë nevojë që të rikthehet në Shqipëri dhe të bëjë përsëri Akademinë e Sigurisë, qoftë për t’u marrë në punë fillimisht, qoftë për të ecur në gradë. Pra, është një plus, është një dritare që u hapet të gjithë atyre që arsimohen jashtë shtetit në institucionet që ofrojnë këtë lloj edukimi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Jam dakord, por në mënyrë indirekte mund të jetë edhe rasti i dikujt që është shtetas i huaj që ka fituar nënshtetësinë shqiptare dhe ka vazhduar ta kryejë shkollimin jashtë Shqipërisë.

Zonja Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Zëvendësministër!

Zonja Sekretare e Përgjithshme,

Në fakt, në lidhje me rastin konkret, mua më duket pak si larg kjo gjëja... Kjo lind nga nevoja e ndonjë rasti konkret, apo është në mënyrë hipotetike, pra nëse ndodh?

Julian Hodaj – E keni fjalën për provimin e gjuhës shqipe?

Ermonela Felaj – Nëse nuk është ky kusht në ligj ose ky kriter në ligj, çfarë ndodh?

Julian Hodaj – Këto janë dispozita që parashikojnë raste hipotetike. Në dijeninë time, nuk kemi raste konkrete.

Ermonela Felaj – Zonja Xhina, edhe një herë, fjala është për ju.

Më pas do ta hedh në votim.

Elena Xhina – Unë vazhdoj t'i qëndroj diskutimit tim dhe, nëse do të ishte shtetas i huaj, qëndron varianti që ju thatë që nuk mund ta fitojë shtetësinë pa ditur gjuhën shqipe në të shkruar dhe në të folur. Nga ana tjetër, nëse është shtetas shqiptar, nuk mund të pretendojmë se nuk di gjuhën shqipe. Kështu që mua më duket një kërkesë e tepërt e ligjit tonë, pasi ne nuk e kemi vendosur tek ata persona që merren drejtpërdrejt me arsimin kriterin që të dinë të zotërojnë gjuhën shqipe dhe jo ta vendosim te ky ligj për gardën. Kështu që unë nuk jam dakord që të qëndrojë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Kolegë, do të kalojmë në votim dhe votojmë sipas propozimit më të largët. Kush është dakord me nenin 20, me propozimin zonjës Xhina, që kriteri i parashikuar në germën “ç” të projektit që të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur të hiqet si i panevojshëm? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Neni 20 votohet me ndërhyrjen e propozuar nga kolegja Xhina.

Neni 21 “Pranimi i punonjësve në funksione të veçanta”. Pra, edhe në Gardën e Republikës, për shkak të natyrës së punës, ka edhe funksione të veçanta që bëhen pjesë e Gardës së Republikës, sikundër në të gjithë Policinë e Shtetit. Nuk kemi pasur diskutime në lidhje me këtë nen, sidoqoftë, nëse kolegët kane pyetje ose diskutime, ju lutem, të m'i thonë?

“Numri i shtetasve të pranuar, sipas këtij neni, nuk mund të jetë më shumë se 3% e limitit të përgjithshëm organik të Gardës së Republikës.”. Ky është limiti.

Atëherë, kush është dakord me nenin 21? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 21.

Neni 22 “Pranimi i ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Gardën e Republikës”: “Për plotësimin e nevojave të veçanta mund të pranohen në Gardën e Republikës ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 21, duke përjashtuar germën “dh” të këtij ligji. Besoj se do të jetë një lapsus. Në nenin 21, përjashtuar shkronjën “dh” të këtij ligji.

Në shkronjën “dh” thuhet: “Të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në fushën përkatëse”.

Pra, nuk kërkohet ky kusht për ata që vijnë nga Forcat e Armatosura, ndërkohë që për gjithë të tjerët, që kanë profesione të veçanta dhe që nevojiten për përmbushjen e misionit të Gardës së Republikës, kushti i të qenit ose i të pasurit një përvoje pune jo më pak 5 vjet qëndron, por vetëm për Forcat e Armatosura propozohet që ky kusht të mos qëndrojë.

Kalimi nga strukturat e Forcave të Armatosura te Garda e Republikës realizohet, natyrisht, duke njohur vjetërsinë e shërbimit, ndërkohë që procedurat, rregullat dhe mënyrat e ekuivalentimit të gradave ushtarake me ato të Gardës së Republikës miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë që kalimi për të gjithë ushtarët e shërbimit aktiv realizohet me pëlqimin e ushtarakut dhe në bazë të marrëveshjes dypalëshe, marrëveshja ndërmjet ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit përgjegjës për Rendin dhe Sigurisë.

Sigurisht që të bëhesh pjesë e Gardës do të thotë të lirohesh nga Forcat e Armatosura, është i njëjti diskutim që ne kemi bërë për Policinë e Shtetit dhe ku e kemi lejuar të hapur mundësinë e përfshirjes, natyrisht përkundrejt një limiti që kemi vendosur në ligj si kufi.

Shoh që nuk ka diskutime.

Artemis Malo – Termin në ligj ta bëjmë nen, sepse është një lapsus, shkronja “dh” e këtij neni.

Ermonela Felaj – Neni 21, në rregull.

Do të bëjmë vetëm një rregullim në përmbajtjen e nenit 22 që është i natyrës gjuhësore, sepse përmbajtja mbetet e njëjtë nuk ndryshon në thelb.

Kush është dakord me nenin 22? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 23 “Arsimimi dhe trajtimi”. “Arsimimi edhe për pjesëtarët e Gardës së Republikës parashikohet të kryhet në institucionin arsimor të Policisë së Shtetit, ministrisë përgjegjëse për Çështjet e Rendit dhe të Sigurisë Publike dhe në institucionet arsimore homologe jashtë vendit. E njëjta gjë qëndron edhe për trajnimet.”

A ka diskutime për këtë nen?

Sipas këtij neni, Garda do të ketë diskrecionin që t’ia paraqesë ose t’ia propozojë vetë kuotat Policisë së Shtetit ose ministrisë lidhur me funksionet që kanë gradën “inspektor”, “nënkomisar”, si dhe të gjitha ato trajnime që bëhen për ecurinë në karrierë, gjë që më duket oportune për Gardën e Republikës.

Kush është dakord me nenin 23? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 24 që ka të bëjë me betimin. Betimi është po ai që ka qenë sot që nga viti 2003, pra gati 18 vjet.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 25 që bën fjalë për transferimin e punonjësve të Gardës. “Punonjësi i Gardës transferohet për nevoja shërbimi, për plotësim të funksioneve organike, për arsye shëndetësore që e kufizojnë në kryerjen e detyrës aktuale”.

Sigurisht që transferimi ndodh duke mbajtur të njëjtën gradë, pra nuk ka ndryshime në gradë për këtë shkak.

Nuk ka vërejtje për këtë nen.

Kush është dakord me nenin 25? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26 “Transferimi në struktura të tjera me gradë”.

“Punonjësi mund të transferohet në struktura me gradë në varësi të Ministrisë për Çështjet e Rendit dhe të Sigurisë Publike bazuar në kërkesat e këtyre të fundit”.

A ka diskutime për këtë nen? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 26? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 27 ka të bëjë me transferimin e përkohshëm, pra punonjësi transferohet në një detyrë tjetër përkohësisht brenda Gardës, kur është e nevojshme për zëvendësimin e përkohshëm të një punonjësi, kur funksioni organik është i paplotësuar dhe për përballimin e organikës së punës si rezultat i situatave të paparashikuara. Transferimi i përkohshëm nuk mund të zgjasë më shumë 6 muaj. Gjatë kësaj kohe punonjësit i ruhet vendi i punës, trajtohet me pagën e vendit të punës që ka pasur përpara transferimit.

Nuk ka vërejtje as për këtë nen.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 28, që parashikon rastet kur punonjësi i Gardës pezullohet nga detyra. Edhe për këtë nen nuk kemi pasur kontestime nga Garda e Republikës dhe ne po insistojmë shumë, sepse normalisht janë të interesuarit e parë, pra grupi i interesit që trajton ky ligj.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29 bën fjalë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe rikthimin.

“Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet”.

Në pikën 2 parashikohen të gjitha rastet e lirimit të punonjësit të Gardës nga detyra.

A ka vërejtje apo kontestime për këtë nen?

Në fakt, janë parashikuar të bashku rastet e lirimit dhe të përjashtimit.

Fjalën e ka zonja Xhina.

Besoj se duhet të bëjmë një shkrirje të pikave 1 dhe 2 që të marrë sens.

Elena Xhina – Përveç asaj, vura re që në pikën 3 ne kemi një mundësi që u jepet disa personave të liruar apo të shkarkuar për të konkurruar. Janë pikërisht ata që kanë kërkuar shtyrje të pikave “c” dhe “dh”.

Në fakt, unë vë re që edhe në pikën “gj”, që ka të bëjë me mosparaqitjen në detyrë për shkaqe të justifikuara, për më shumë se 7 ditë pune, nuk është ndonjë shkelje kaq shumë e rëndë sa të mos u japësh të drejtën individëve për të konkurruar përsëri. Unë propozoj që të hyj edhe pika “gj” tek e drejta për të konkurruar dhe për t’u rikthyer, përveç bashkimit të pikës 1 me pikën 2.

Sa i takon pikës “gj” nuk e shoh si shkelje kaq të rëndë sa të mos u jepet e drejta individëve për t’u rikthyer dhe për të konkurruar.

Ermonela Felaj – Zoti Hodaj, e ka fjalën.

Para se të përgjigjet zoti Hodaj, do të gjykoja se do të ishte e përshtatshme që pika 1 të shkrihej së bashku me pikën 2 dhe të thuhet: “Punonjësi i Gardës ndërpret marrëdhëniet e punës kur lirohet ose përjashtohet si më poshtë”, meqenëse është bërë një përzierje e rasteve të lirimit me rastet e përjashtimit.

Jualian Hodaj – Po e nis nga fundi, dakord, zonja kryetare!

Ermonela Felaj – Kur ai dënohet nuk lirohet, por përjashtohet nga Garda e Republikës.

Julian Hodaj – Jam dakord me propozimin tuaj të fundit që të bashkohen të dyja pikat, ajo ishte thjesht për të përcaktuar që ekzistojnë dy mundës: ose lirim, ose përjashtim.

Për t’iu përgjigjur zonjës Xhina, më duhet t’i them se pikat “f”, “g” dhe “gj” janë arsye për përjashtim jo për lirim. Ndoshta edhe për ta saktësuar brenda pikës 2 mund edhe të specifikohet se cili rast është lirim dhe cili rast është përjashtim, sepse janë të dyja bashkë. Lirimi dhe përjashtimi janë dy rrethana të ndryshme, pra në rastin e lirimit kemi arsye objektive, dikush që humb shtetësinë, dikush që e humbet zotësinë, dikush që kërkon të ikë, ndërsa në rastin e përjashtimit kemi arsye subjektive që kanë lidhje me sjelljen e vetë punonjësit. Punonjësit të përjashtuar nuk i jepet mundësia për rikthim.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Hodaj!

A ka opinione të tjera nga kolegët?

Zonja Xhina.

Elena Xhina – Në variantin që kam përpara thuhet: “Punonjësi lirohet nga detyra kur...” dhe nuk shoh asnjë përjashtim këtu. Pika 3 vazhdon: “Një punonjësi të liruar, sipas shkronjës “c”, “e” dhe “dh” të pikës 2 të këtij neni i lind e drejta të konkurrojë për t’u rikthyer në strukturat e Gardës kur krijohen vende të lira”.

Pra, termin “përjashtim” nuk e lexoj fare te varianti që unë kam, por nëse kam variant të gabuar, ju kërktoj ndjesë!

Julian Hodaj – Keni të drejtë zonja Xhina, pasi varianti që ju keni nuk e ka fjalën “përjashtim”, por normalisht arsyet që unë ju thashë janë arsye përjashtimi dhe jo lirimi.

Elena Xhina - Ato duhet të jenë në ligj jo me fjalët tona, Juli, duhet të jenë këtu brenda.

Julian Hodaj – Dakord.

Meqë neni fillon me lirohet ose përjashtohet, presupozohet që t’i mbulonte të dyja. Ju keni të drejtë dhe ne duhet ta bëjmë këtë saktësim, siç edhe jua thashë pak më parë.

Ermonela Felaj – Kolegë, ju njoftoj, meqenëse votimin në tërësi mendohet ta bëjmë në një mbledhje tjetër, pasi të sigurohemi për zbardhjen korrekte të tekstit, ta rishikoni nenin 29 me përmbajtjen e të cilit jeni dakord në tërësi, por mendojmë që duhen ndarë rastet e lirimit dhe rastet e përjashtimit me qëllimin që të shohim qartë se cilët nga punonjësit do të kenë të drejtën për t’u rikthyer në strukturat e Gardës. Normalisht, ideja është që të rikthehen ata që lirohen dhe jo ata që përjashtohen që të bëhet një diferencë.

Do të doja që ta rishkruanim këtë nen dhe në votimin në tërësi ta shihnim në zbardhjen përfundimtare, meqenëse edhe ju patët dilemë për këtë gjë.

Kalojmë te neni 30 “E drejta e informimit dhe e ankimit”.

“Punonjësi i Gardës ka të drejtën e informimit për fillimin e çdo procedimi administrativ apo disiplinor dhe për çdo vendim përfundimtar që ka të bëjë me marrëdhëniet e punës. Punonjësi, për rastet që mendon se largimi ose përjashtimi nga puna është bërë pa shkaqe të justifikuara ka të drejtë të paraqesë ankesë, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Gardës dhe të legjislacionit përkatës në fuqi”.

A keni ndonjë ndërhyrje në lidhje me këtë nen?

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Ndoshta u bëra pak e bezdisur. Doja të dija, po rastet e pezullimit a hyjnë tek e drejta e ankimit?

Pra, në momentin që punonjësi pezullohet, a ka të drejtë të paraqesë ankim?

Ermonela Felaj – Kush nga përfaqësuesit e ministrisë do ta marrë fjalën, zoti Shehu apo zonja Pici?

Zoti Shehu, fjala për ju, pasi kemi një shkëputje me zotin Hodaj.

Fatmir Shehu – Pyetja që bëhet nga zonja Xhina është mëse e drejtë. Sigurisht, në lidhje me këtë nen aplikohen edhe parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, që lidhet me pjesën e momentit të pezullimit dhe të drejtën e ankimit për çdo fazë procedurale. Nëse e vlerësojnë, atëherë po e shtojmë edhe këtë si parashikim në lidhje me momentin e pezullimit, por patjetër që kanë të drejtë edhe gjatë fazës së pezullimit.

Ermonela Felaj – Po, faleminderit!

A mund të kemi një propozim alternative për përmbajtjen e këtij neni? Besoj se duhet t'ua bëjmë pak më të qartë të drejtat punonjësve të Gardës, jo thjesht t'i adresojmë në përgjithësi për legjislacionin që duhet të shohin para se të ushtrojnë një të drejtë, siç është ajo e ankimit. Në ligjet e tjera e kemi saktësisht ku kanë të drejtë të ankohen dhe cilit ligj t'i referohen. Kjo është një detyrë për Ministrinë e Brendshme për ta konfiguruar siç duhet këtë nen, në përputhje me standardet e njohura dhe në ligjet e tjera të ngjashme.

Kalojmë të neni 31 “Vlerësimi i punonjësit”, ku thuhet: “Punonjësi u nënshtrohet testeve dhe vlerësimit vjetor periodik të punës. Elementet që testohen dhe vlerësohen, procedura dhe kompetencat për vlerësimin përcaktohen në rregulloren e Gardës”.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu VI “Gradat”.

Neni 32 “Gradat dhe hierarkia”. Ne thamë se gradat me projektligjin e ri për Gardën ndryshojnë. Nuk kemi më grada ushtarake, por gradat njësohen më ato policore. Besoj se kjo është një kërkesë e kahershme e punonjësve të Gardës së Republikës, për të ardhur në këtë pikë. “Klasifikimet e niveleve sipas hierarkisë janë: bazë , i mesëm, i lartë, madhor”. Më poshtë do të flasim edhe për gradat konkrete.

A keni vërejtje për nenin 32?

Zonja Dhima?

Antoneta Dhima – Jo.

Ermonela Felaj - Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 33, “Emërtimi i gradave”. Emërtimi i gradave parashikohet ose propozohet të jetë i tillë: “Për punonjësit e nivelit bazë gradat “Inspektor” “Inspektorit të dytë”, “Inspektor i parë”; për punonjësit e nivelit të mesëm gradat do të jenë “Nënkomisar”, “Komisar” “Kryekomisar”; për punonjës të nivelit të lartë gradat do të jenë “Drejtues” dhe “Drejtues i parë” dhe për punonjësit e nivelit madhor gradat do të jenë “Drejtues i lartë” dhe

“Drejtues madhor”. Pra, ky do të jetë sistemi i gradave që propozohet në ligjin “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”

Garda ka rënë dakord me këtë klasifikim gradash sipas niveleve. Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34 “Kriteret për fitimin e gradës”. “Ecuria me gradë e punonjësit të Gardës bëhet nëpërmjet fitimit të njëpasnjëshëm të gradave, në përputhje me kriteret e përcaktuara për çdo gradë, si më poshtë vijon:

a. Të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më ulët se 70% të pikëve të vlerësimit të përgjithshëm gjatë kohës së qëndrimit në gradë.

b. Të ketë përfunduar arsimin dhe kualifikimin përkatës për gradën për të cilën konkurron, sipas përcaktimeve të nenin 37 të këtij ligji.

c. Të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë sipas afateve”.

Këto, në fakt, do t’i shohim më poshtë në nenin 36 të ligjit. Janë kritere që shumë ngjashëm i gjejmë në ligjin për karrierën në Forcat e Armatosura. Edhe aty ka kohë të caktuar të qëndrimit në gradë.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 35 “Kriteret për aplikim për gradimin e radhës”. Unë nuk po i përsëris, sepse i keni këtu, por ndërkohë dua t’ju them se për këtë nuk ka pasur ndonjë kundërshti, grupi i punës është i dakordësuar.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36 “Afatet e qëndrimit në gradë”. Janë parashikuar disa afate. “Për marrjen e gradës “Inspektor i dytë” duhet qëndrimi 5 vjet në gradën “Inspektor”; nga “Inspektor i dytë” në “Inspektor i parë” 10 vjet; nga “Nënkomisar” në “Komisar” 3 vjet; nga “Komisar” në “Kryekomisar” 3 vjet; nga “Kryekomisar” në “Drejtues” 5 vjet; nga “Drejtues” në “Drejtues i parë” 3 vjet. A keni ndonjë pyetje?

Zonja Dhima.

Antoneta Dhima - Unë shoh që midis gradës “Inspektor” në “Inspektor i parë” ka diferencë krahasuar me gradat e tjera. Mos duhet të rishikohet ky afat dhe nga 10 vjet të bëhet 7 vjet?

Ermonela Felaj - Edhe unë këtë pyetje kisha. Ideja është që të mos krijohen diferenca në lëvizjen në gradë. Kështu duhet të kemi parasysh që aktualisht nga procesi i njësimimit të

gradave që kanë punonjësit e Gardës, nga grada ushtarake në gradë policore, çfarë efektsh mund të krijohen nga kjo? Gjithmonë për afatin, a mund ta propozojmë 7 vjet dhe jo 10 vjet?

Juljan Hodaj - Sekretari ka ndjekur të njëjtën logjikë siç është ndjekur edhe te ligji për Policinë e Shtetit në lidhje me ecurinë në gradë. Sa kohë presupozohet që dikush mund të pranohet në Gardën e Republikës edhe 18 vjeç, besoj se i duhet koha e mjaftueshme të kalojë gradat. Të mos harrojmë që ligji ka hapur edhe dritare për ata që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit të dytë, të cilët mund të pranohen direkt te grada “Nënkomisar”. Pra, është ideja për të siguruar njëtrajtshmëri në trajtimin e të gjithë punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Sa i përket pyetjes a duhet 10 vjet apo 7 vjet, besoj se është shumë teknike për mua që të jap përgjigje, por sa kohë që komandanti i Gardës ka qenë edhe kryetari i grupit të punës, e ka parashikuar vetë, mendoj se ata i dinë më mirë vitet e nevojshme për të krijuar një eksperiencë të caktuar për të ecur më tutje në gradë.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A keni opinione të tjera nga kolegët! Nuk ka.

Atëherë, unë do të propozoja që të kalojmë në votimin e këtij neni, duke ju kërkuar që të shikohet ky moment, nëse mund të bëhet 7 vjet afati, por pa insistuar, gjithmonë duke kuptuar që, nëse vihet 7, implikon ndonjë problematikë, nëse implikon ndonjë problematikë, të cilën ne nuk e dimë se nuk jemi njerëz teknikë të kësaj gjëje, le të mbetet 10 vjet.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pra, shpresoj të jetë mirëkuptuar ndërhyrja ime. Të merrni kontakt me Gardën e Republikës për ta saktësuar.

Kalojmë te neni 37 “Arsimi dhe kualifikimet për fitimin e gradës”. Ka disa kurse që janë të detyrueshme për fitimin e gradës. Për shembull, për gradën “Inspektor i dytë” duhet të ketë përfunduar kursin e trajnimit për inspektor i dytë punonjësi i Gardës që do të marrë këtë gradë dhe për çdo gradë ka një kurs trajnimi specifik, i cili është si parakusht për çdo punonjës që kalon nga një gradë në tjetrën.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 38 “Dhënia dhe fitimi i gradës”. A kemi ndërhyrje për këtë nen.

Artemis Malo - Po, ka një ndërhyrje te pika një, pra “Dhënia dhe fitimi gradës”, “Për gradat nga “Inspektor” deri “Drejtor i parë” jepen nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës, ndërsa gradat “Drejtues i parë” dhe “Drejtues i lartë” jepen nga ministri”.

Juljan Hodaj – Mbi bazën e ndryshimeve që sapo bëmë, vetëm grada “Drejtues i lartë” jepet nga ministri.

Artemis Malo – Po, vetëm grada “drejtues i lartë” jepet nga ministri.

Ermonela Felaj– Pra, keni rënë dakord për këtë ndryshim, ku diskutuam për kompetencat dhe përgjegjësitë e ministrit dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Përgjithshëm të Gardës.

Me këtë ndërhyrje korrektuese të përmbajtjes së nenit 38 të projektligjit ju ftojme të votojmë.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 39 “Procedura e aplikimit dhe e verifikimit”.

Artemis Malo – Po, këtu jemi dakordësuar me versionin e Gardës.

Ermonela Felaj – Lexojeni, ju lutem!

Artemis Malo – “Konkurrimi për gradën “Inspektor i dytë” deri në “Inspektor i parë” dhe “Komisar” deri në “Drejtues i parë” behët nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces testimi dhe vlerësimi. Drejtori i Përgjithshëm shpall fillimin e konkurrimit për gradë pas evidentimit të vendeve të lira në strukturën e burimeve njerëzore. Konkurrimi për gradë bëhet vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e Gardës, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj dhe procedurat e konkurrimit të përcaktuara në rregulloren e Gardës”.

Ermonela Felaj– Zoti Hodaj, a jeni dakord? Dakord.

Atëherë, nuk kemi vërejtje të tjera për këtë nen.

Kush është dakord me këtë nen? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ndërkohë na vjen një sqarim nga Garda, me sa duket janë duke na ndjekur, sepse mbledhja është *live* dhe ka akses kushdo që dëshiron.

Sa i përket nenit 36, për të cilin ne diskutuam, për kohën e qëndrimit në gradë nëse duhet të ishte 10 – 7 vjet, ka ardhur një përgjigje sqaruese ku thuhet: “Për nenin 36 koha e qëndrimit në gradë 10 vjet për “Inspektori i parë” është propozuar e tillë, sepse në organikë janë pak vende me këtë gradë, sepse konsiderohet gradë e lartë e “Nënoficerit”.” Kjo është arsyeja praktike për të cilën është propozuar afati 10 vjet.

Kalojmë te neni 40 “Fazat e testimit të kandidatëve”. “Për fitimin e gradës “komisar” kandidati vlerësohet në testim me shkrim dhe intervistë me gojë. Për fitimin e gradës “Kryekomisar” deri në “Drejtues i parë”, kandidati vlerësohet me testim me shkrim, me

ushtrime vlerësuese dhe intervistë me gojë. Kufiri minimal për kalimin me sukses të testimit përkatës përcaktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës që në momentin e shpalljes së fazës së aplikimeve, por ai nuk mund të jetë më i ulët se 70%”.

Ka sugjerime për këtë nen, kolegë? Nuk ka.

Kush është pro me nenin 40? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 41 “Procesi i ankimit”.

Artemis Malo – Këtu, në fakt, është dakordësuar që të mbahet versioni i Gardës sërish, i cili është konkretisht “Ankimi për gradat”.

“Punonjësi i Gardës ka të drejtën e ankimit kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit pranë Komisionit të Apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.

Kundër vendimit të Komisionit të Apelimit, punonjësi i Gardës ka të drejtë të ankohet në gjykatë.

Përbërja, detyrat dhe kompetencat e Komisionit të Apelimit, si dhe rregullat e procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në rregulloren e Gardës”. Pra, ka ndryshim nga procesi i ankimit, që ishte konkretisht në nenin 41, dhe kjo është përmbledhur vetëm në 3 pika.

Ermonela Felaj – Zoti Hodaj, ka disa ndryshime, në fakt, si, për shembull, Komisioni i Apelimit, sipas presupozimit tuaj, do të ngrihej me urdhër të ministrit, ndërkohë që, me propozimin e Gardës, do të ngrihet sipas asaj që Garda do të parashikojë në rregulloren e saj. Jeni dakord?

Juljan Hodaj – Kjo nuk përjashton mundësinë që prapë ministri të jetë ai që cakton përbërjen e Komisionit të Gardës. Kuptohet, në logjikën tonë është që qoftë në komisionet e gradimit, qoftë në komisionet e apelimit... *(Nuk kuptohet)* ndryshimi ndërmjet dy varianteve është i thjeshtë. Neni i propozuar fillimisht kishte më shumë detaje dhe shkonte më thellë në procedura, që duhet t’i lihen patjetër rregullores që e shtjellon më mirë qëllimin që ka ligji, që duhet të mbetet gjithmonë abstrakt, do të thosha.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Ndërkohë, ka edhe një ndryshim tek titulli, sepse titulli i propozuar nga ju është “Procesi i ankimit”, ndërkohë, titulli sipas variantit të Gardës është “Ankimi për gradën”.

Ju ftoj që, meqenëse jeni dakord, në zbardhje ta rishikoni në detaje përmbajtjen e këtij neni, meqenëse nga kolegët e Komisionit të Sigurisë nuk ka ndërhyrje tjetër.

Kalojmë te neni 42 “Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion”. “Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese. Përcaktimi i gradave korresponduese për çdo funksion miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave”. Nuk kemi vërejtje për këtë nen. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te kreu VII “Trajtimi i personelit”, neni 43 “Koha e punës dhe e pushimit”. Natyrisht, janë të drejta të rëndësishme për punonjësit e Gardës. Kush është dakord?

Juljan Hodaj – Kryetare, më falni!

Thjesht për të shkuar me logjikën që shkuam, sepse edhe ky nen është modeluar sipas logjikës që struktura dhe organika do të miratohej me vendim të Këshillit të Ministrave. Duke qenë se ju miratuat që struktura dhe organika miratohet me urdhër të ministrit të Brendshëm, edhe kjo duhet modifikuar në të njëjtën logjikë.

Ermonela Felaj – Që do të thotë se për nevoja të punës dhe interesat të shërbimit koha e punës ditore mund të zgjatet tej kohës normale të punës me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm...

Juljan Hodaj –E kam fjalën për nenin 42, kryetare. Më falni, se ndoshta nuk u kuptova si duhet. Bëhet fjalë për nenin 42, kur flasim për përcaktimin e gradave korresponduese për çdo funksion.

Ermonela Felaj – Thamë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Doni të shtoni “me propozim të ministrit”?

Juljan Hodaj –Jo, kryetare!

Ju miratuat që struktura dhe organika miratohet me urdhër të ministrit të Brendshëm dhe gradat për çdo funksion janë pjesë e strukturës dhe organikës, nuk mund të jenë një gjë e veçantë. Pra, në momentin që Garda miraton strukturën dhe organikën, miraton edhe gradat për secilin funksion. Ndaj po them që edhe këtu duhet zëvendësuar jo me “vendim të Këshillit të Ministrave”, por “me urdhër të ministrit të Brendshëm”.

Ermonela Felaj – E kuptova! Mendova se ndërhyrja juaj ishte për nenin 43.

Juljan Hodaj –Ndjesë, se nuk po lidhesha dot!

Ermonela Felaj – Atëherë, në nenin 43 jemi duke folur për kohën e punës ditore të Gardës së Republikës dhe për pushimet e tyre.

“Punonjësi i Gardës, si çdo punonjës tjetër në Republikën e Shqipërisë, e gëzon të drejtën e pushimit vjetor dhe pushime të tjera të pagueshme. Pushimi vjetor për punonjësit e Gardës së Republikës është 28 ditë deri në 45 ditë kalendarike dhe jepet i shkallëzuar sipas funksioneve dhe gradave”. Jeni dakord me këtë nen? Garda vetë ka qenë dakord.

Antoneta Dhima - Kryetare, kam një pyetje. Çfarë kuptojmë me “pushime të tjera të pagueshme”?

Ermonela Felaj – Janë raste gëzimesh ose fatkeqësish, ku Kodi i Punës u jep të drejtë punonjësve që t’i marrin këto ditë pushim dhe ndërkohë të jenë ditë të paguara. Kjo është ideja.

Antoneta Dhima – Por mund të specifikohet, sepse në raste vdekjeje, sipas Kodit të Punës...

Ermonela Felaj – Kodi i Punës është i detyrueshëm për zbatim, sepse është ligj i cilësuar, ndërsa ligji për Gardën dhe ligje të tjera janë ligje të thjeshta, për rrjedhojë kur vjen puna te koha e pushimit dhe lejes, automatikisht do të zbatohen dispozitat që parashikon Kodi i Punës. Kështu që, kam përshtypjen që kjo është thënë në mënyrë të përgjithshme, sepse praktikisht është e qartë. Megjithatë, për merakun tuaj, mund ta shohim, që të kemi një propozim më të plotë.

Kalojmë te neni 44 “Leja pa të drejtë page”.

“Punonjësi i Gardës gëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në dy muaj ose afatgjatë deri në 3 vjet. Leja afatshkurtër jepet nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës dhe pas përfundimit të lejes, punonjësi kthehet në të njëjtën detyrë.

Leja afatgjatë jepet vetëm për studime nga drejtori i Përgjithshëm i Gardës së Republikës.

Rregullat dhe procedurat e lejes pa të drejtë page përcaktohen në rregulloren e Gardës”.

Keni ndonjë vërejtje për këtë nen? Kush është dakord me nenin 44? Dakord.

Miratohet.

Kalojmë te neni 45 “Kujdesi për gratë shtatzëna”.

“Punonjëset shtatzëna ose me fëmijë në gji nuk mund të punojnë në funksione pune, që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijës. Nuk lejohet puna e natës për punonjëset shtatzëna. Funksionet që dëmtojnë shëndetin e tyre dhe të fëmijëve përcaktohen në rregulloren e Gardës”. Kemi ndërhyrje për këtë nen?

Kam parasysh, zonja Elona, dhe ndaj ju ftova që ta diskutojmë në këtë moment, edhe në institucionet ku punojmë, shoh që ka të angazhuar edhe burra. Natyrisht, që është vendi, por që të zëvendësosh punonjësen e Gardës, grua, në një institucion siç është Kuvendi i Shqipërisë, për të sjellë mosha të reja ose burra, për mua ka një problem, në gjykimin tim. Ndoshta ne, si gra deputete dhe si anëtare të këtij komisioni, duhet të rezervojmë një mbrojtje më të madhe me ligj për gratë që janë punonjëse të Gardës së Republikës, por që për shkak të moshës, për

shkak se janë familjare, për shkak se janë nëna, sigurisht që duhet një vëmendje e shtuar edhe në drejtim të funksioneve që atyre u ngarkohen të kryejnë.

Elona Gjebrea - Jam dakord me ju, zonja kryetare!

Do të propozoja të dalim me një amendim, ne gratë e komisionit, pse jo edhe Aleanca e Grave Deputete, sepse vërtet është një gjë shqetësuese dhe në mënyrë të heshtur kalojnë disa problematika, që duhet të kenë më shumë vëmendje nga ana jonë.

Kështu që, vetëm për efekt kohe apo për efekt të një diskutimi pak më të ngushtë midis nesh, nëse mundet vetëm këtë nen ta diskutojmë në mënyrë të ngushtë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Do të doja që nenet 45 dhe 46, që kanë të bëjnë posaçërisht me gratë dhe vajzat, ta rishikojmë. Të mos ruajmë këto formulimet që duken shumë të vjetra në përmbajtje dhe në qasje.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 47 “Trajtimi financiar në marrëdhënie pune”.

“Punonjësi, për shkak të përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së lartë në detyrë, trajtohet me pagë mujore bruto, që përbëhet nga paga për gradë, shtesa mbi pagë për vjetërsi shërbimi, shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune dhe shtesë mbi pagë për dëmshmëri shëndeti, shtesë mbi pagë për funksione të veçanta”. “Dëmshëmëri” duhet zëvendësuar me fjalën “Për pasoja në shëndet”.

Ndërkohë që kemi “trajtimin për ushqim, ndihmën financiare në raste të fatkeqësive në familje, shpërblim deri në masën e tri pagave mujore, ndihmë e menjëhershme financiare në raste të dëmtimit të rëndë të pronës private për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit në dëm. Procedurat e trajtimit financiar gjatë qëndrimit në punë të punonjësit të Gardës së Republikës, sipas këtyre që lexuam më sipër, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ky është trajtimi financiar që parashikohet të kenë punonjësit e Gardës së Republikës, që besoj, krahasuar me trajtimin që ne u kemi rezervuar për natyra të përafërta pune, arsye shëndetësore, kemi diskutuar edhe për punonjësit e Policisë së Burgjeve, ku u bënë disa sistemime, në fakt, për trajtimin financiar të tyre, por njëkohësisht një nga trajtimet financiare të punonjësve të Policisë së Shtetit, besoj që përmbajtja...

Antoneta Dhima – Kryetare, shtesa mbi pagë për dëmshmëri shëndeti është e specifikuar shumë drejt edhe në bazë të VKM-ve dhe të urdhrave të...

Ermonela Felaj – E kisha për fjalën “dëmshmëri”, se nuk është fjalë e fjalorit shqip.

Antoneta Dhima – Janë edhe aktet nënligjore që kanë dalë dhe kështu është e specifikuar, kështu që nuk e ndryshojmë dot.

Ermonela Felaj – Aktet nënligjore duhet t'i përgjigjen ligjit. Të korrigjohet ligji, që të korrigjohen edhe aktet nënligjore.

Antoneta Dhima – Edhe në aktet nënligjore të Forcat e Armatosura, kështu është e specifikuar, kështu është e specifikuar edhe në udhëzimet për të gjithë punonjësit, të cilët punojnë në funksione, të cilat kanë dëmshmëri për shëndetin e tyre.

Ermonela Felaj – Megjithatë, zonja Dhima, unë do të refuzoja që të përdorim këtë fjalë. Diskutimi këtu nuk është se kjo është fjalë e huaj, por se fjala “dëmshmëri” nuk ekziston fare në fjalorin e shqipes. Kështu që ne duhet të përdorim diçka që të kuptohet drejt, si “dëme në shëndet” ose “pasoja në shëndet”.

Antoneta Dhima – E ka eksperiencën e trajtimit financiar të Forcave të Armatosura...

Ermonela Felaj – Ne do ta verifikojmë. Nuk është se nuk jam dakord, por duhet fjala e duhur dhe nuk ka absolutisht asgjë. Pse ne nuk e kuptojmë dot fjalën që është shqip dhe është në fjalorin e gjuhës shqipes dhe kuptuakemi një fjalë që nuk është fare në fjalor, por që do ta krijojmë?!

Antoneta Dhima – Këtu është bashkuar dëmi që i jep njeriut në shëndet dhe shkruhet “dëmshmëri”.

Ermonela Felaj – Nuk mund ta themi pra fjalën “dëmshmëri” apo “pasojsshmëri”, se nuk janë fjalë, por themi “dëm” apo “pasoje”. Megjithatë, do ta verifikojmë edhe këtë pjesë dhe do ta korrigjojmë.

A jeni dakord që në përmbajtje paga të jetë e specifikuar kështu, pra pagë mujore bruto me atë përbërje që kanë: trajtim me ushqim; ndihma financiare në rastet e fatkeqësive në familje; shpërblim deri në masën e tri pagave mujore dhe ndihmë e menjëhershme financiare, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës private, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit? Pra, kush është dakord me nenin 47? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 48 “E drejta për sigurim shëndetësor”. Natyrisht, punonjësve të Gardës së Republikës do t'u njihet edhe e drejta që të jenë të siguruar për shëndetin e tyre dhe për shërbime, të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Unë, në fakt, dua të bëj një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë, sepse kjo gjë ka qenë e parashikuar në ligj edhe për punonjësit e policisë, edhe për punonjësit e shërbimeve të veçanta. Për shembull, më kujtohet që gjatë vizitës që ne kemi bërë në repartin e RENEA-s

janë ngritur shqetësime lidhur me daljen e aktit nënligjor, që rregullon specifikisht marrjen e këtyre shërbimeve shëndetësore, që nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Kam parasysh shërbimet më të përgjithshme që marrim, *check-up*-in, dializën dhe shërbime të tjera. A mund të kemi ndonjë sqarim nga ana juaj, a ka ndryshuar ndonjë gjë në këtë pikë? Në rregull, ne po ua njohim këtë të drejtë punonjësve të Gardës njëloj si pjesës tjetër të punonjësve të Policisë së Shtetit, por gjithsesi na përditësoni pak se çfarë ka ndodhur?

Po, zonja Pici.

Elena Pici – Dakord, zonja kryetare, po e marr unë fjalën, meqenëse zoti Hodaj mund të jetë shkëputur. Në lidhje me këtë parashikim, ne e gjetëm me shumë vend që, gjithashtu, të parashikonim një lloj të drejte edhe për punonjësit e gardës, ashtu si edhe për strukturat e tjera që janë në varësi të Ministrisë së Brendshme, siç është Policia e Shtetit. Megjithatë, jemi përpjekur që të jemi konkretë dhe me këmbë në tokë në lidhje me parashikimet e këtij neni, duke e specifikuar që shërbimet shëndetësore shtesë nuk janë ato që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Gjithashtu, në dispozitat kalimtare kemi përcaktuar që ky nen faktikisht fillon të aplikohet nga janari i vitit 2024. Kjo për të qenë në përputhje me planifikimin financiar afatmesëm, duke qenë se aktualisht ne po punojmë për PBA-në 2022-2024 dhe nuk mund ta përfshinim dot në 2021-2023, që është përmbyllur. Duke qenë se ky është një parashikim me efekte të konsiderueshme financiare, për të cilën nevojitet edhe një studim tregu, është parashikuar në dispozitën kalimtare që do të fillojë nga viti 2024, në mënyrë që ne të sigurohemi që ky parashikim është edhe pjesë e buxhetit të programit të Gardës së Republikës. Sigurisht, kemi edhe mbështetjen e Ministrisë së Financave në realizimin e kësaj pritshmërie jo vetëm si një akt nënligjor, por edhe në përmbushje të financave që janë të nevojshme për ta realizuar atë konkretisht.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Pra, është vetëm një dispozitë e natyrës deklarative dhe ne ua njohim të drejtën, duke shpresuar që nga 1 janari i vitit 2024 të jemi realisht këtu për ta njohur konkretisht këtë të drejtë. Atëherë, kush është dakord me nenin 48? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49 “E drejta për përfitim kredie me interesa të butë”.

Kush është dakord me nenin 49? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 50 “Kompensim për strehim”: “1. Kur punonjësi i nivelit të mesëm e të lartë emërohet apo transferohet në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm, kur nuk i

sigurohet nga Garda ambient (thamë se fjala “ambient” do të bëhej “mjedis”) për akomodim, ai kompensohet për shpenzimet e strehimit.

2. Masa ditore e përfitimit dhe procedura e kompensimit për strehim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Kush është dakord me nenin 50? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 51, ku sanksionohet mbrojtja e veçantë. Në rast se punonjësit apo ndonjë pjesëtari të familjes së tij i kërcënohet jeta për shkak të detyrës, ai ka të drejtë për mbrojtje të veçantë.

Zonja Xhina ka një pyetje.

Elena Xhina – Unë jam dakord me dispozitën, por thjesht për teknikëve legjislativë aty ku thuhet “ai ka të drejtë për mbrojtje të veçantë” do të propozoja shprehjen “ai gëzon mbrojtje të veçantë”. Kjo është thjesht për teknikë legjislativë, por si ta vendosni ju pastaj.

Ermonela Felaj – Më falni, edhe një herë si propozoni?

Elena Xhina – Pra, të bëhet: “Në rast se punonjësit apo ndonjë pjesëtari të familjes së tij i kërcënohet jeta për shkak të detyrës, ai gëzon mbrojtje të veçantë.”

Ermonela Felaj – Në rregull!

Diferenca midis shprehjes “ka të drejtë” dhe “gëzon mbrojtje të veçantë” është thjesht...

Elena Xhina – Sepse në momentin që ne themi “gëzon” automatikisht e ka të përfituar të drejtën, kurse kur themi “ka të drejtë” ndoshta duhet të aplikojë për ta fituar të drejtën. Pra, “gëzimi” është në nga tagrat që është më e disponueshme.

Ermonela Felaj – Mos ndoshta duhet verifikuar që kjo situatë është e vërtetë që atij i kërcënohet jeta për shkak të detyrës dhe jo për ndonjë shkak tjetër?

Elena Xhina – Kjo është te pika e dytë, ku thuhet: “Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë për punonjësit përcaktohen në rregulloren e gardës”. Pra, aty duhet të jenë kushtet se si verifikohet, sepse edhe kur themi “ka të drejtën”, përsëri do të verifikohet. Megjithatë, kjo është teknikë legjislativë dhe mua më duket sikur shkon më tepër duke ndenjur në termat e legjisllacionit tonë.

Ermonela Felaj – Pra, “gëzon të drejtën për mbrojtje të veçantë”.

Elena Xhina – Po.

Ermonela Felaj – Atëherë, kush është dakord me nenin 51 me këtë ndërhyrje korrektuese në pikën 1 të këtij neni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 52 “Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës”. Pagesat, në fakt, janë po ato që përcaktohen në ligjin që i përmbledh Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Gardën, SHÇBA-në dhe Shërbimin Informativ.

Kush është dakord me nenin 52? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 53 “Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës”. Këtu ka disa specifikime për ndihmat financiare që familjarët e punonjësit të gardës përfitojnë në rastin kur ai humbet jetën për shkak të detyrës. Nuk ka pasur diskutime për këtë nen dhe nuk e di nëse kanë kolegët.

Pra, “1. Kur punonjësi humb jetën në krye apo për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:

a) ndihmë të menjëhershme financiare deri në 10 paga mujore, sipas pagës së muajit të fundit të shërbimit;

b) pension familjar suplementar në masën 100% të pagës së muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit;

c) rimbursim në masën 100% të bursës së studimit në institucionet e arsimit shtetëror për fëmijët e punonjësit;

ç) banesë falas për bashkëshorten dhe fëmijët kur janë të pastrehë;

d) ndihmë financiare në masën e 1 page mujore çdo përvjetor vdekjeje;

dh) ceremonia mortore organizohet nga drejtuesi i strukturës dhe shpenzimet paguhen nga buxheti i Gardës së Republikës;

e) punësim me prioritet për fëmijët, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kritere të tjera të nevojshme për vendin e punës.

2. Familjet e shtetasve, të cilët humbin jetën për shkak të kryerjes së detyrave në ndihmë të strukturave të Gardës së Republikës, përfitojnë në mënyrë të njëjtë çdo ndihmë dhe trajtim të parashikuar në pikën 1 të këtij neni...”. Pra, është ajo që sapo lexuam, ndaj nuk po i shkoj deri në fund nenit, pasi ju i keni përpara. Besoj se është parashikuar rezervimi i një trajtimi të përshtatshëm për punonjësit e gardës, të cilët humbin jetën në krye të detyrës. A keni sugjerime për këtë nen? Nuk ka.

Atëherë, kush është dakord me nenin 53?

Antoneta Dhima – Kryetare...

Ermonela Felaj – Zonja Antoneta, vetëm më thuaj kur do ta marrësh fjalën, sepse më duket sikur jeni dakord direkt.

Antoneta Dhima – Kam vetëm një pyetje, pasi në nenin 47 ne specifikuam nga se përbëhet paga bruto. Tani ne vijmë me ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 paga mujore, sipas pagës së muajit të fundit të shërbimit. Ne duhet të ndajmë nëse është pagë neto apo pagë bruto, sepse normalisht fitimi është pagë neto dhe ndoshta duhet të specifikohet “të pagës neto”?

Ermonela Felaj – Në fakt, si ndodh zakonisht?

Antoneta Dhima – Paga e muajit të fundit i bie të jetë paga neto që ka përfituar ai, pra atë që merr jo të pagës bruto.

Ermonela Felaj – Ndoshta duhet të specifikohet në ligj në qoftë se ka ndonjë praktikë pune të njohur.

Antoneta Dhima – Pra, të pagës neto çka ai ka përfituar ka marrë.

Ermonela Felaj – A mund të parashikohet në ligj ky element teknik financiar, në qoftë se ka një praktikë pune të njohur në këtë drejtim? Këtë pyetje e kam për ju, zoti Hodaj, ose edhe për...

Julian Hodaj – Është praktikë e konsoliduar ajo që paga është gjithmonë neto dhe rregullat dhe detajimet i lihen një VKM-je, kështu që nuk besoj se do të kemi ndonjëherë kontestime në këtë pikë.

Ermonela Felaj – Në rregull!

Mund edhe ta saktësojmë me një komunikim me njerëzit teknikë të ministrisë, por besoj se në përmbajtje nuk do të ketë problem.

Julian Hodaj – Kryetare, ju thashë se është një praktikë e konsoliduar, pasi, për fat të mirë, te garda nuk është përdorur shpesh, ndërkohë që te Policia e Shtetit është përdorur më shpesh, ndaj VKM-ja e policisë, që do të merret për model, sepse kemi pothuajse të njëjtin trajtim, është e qartë dhe nuk ka pasur kontestime në këtë pikë.

Nëse doni ta specifikoni në ligj, mund ta specifikoni, por unë nuk e shikoj si problem nga ana e Ministrisë së Brendshme.

Antoneta Dhima – Zoti Hodaj, në nenin 47 ju theksoni: “Paga mujore bruto”, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesë e të tjera, është e specifikuar. Tani nëse do të thoni: “Pagës së muajit të fundit”, i bie që do të jetë paga bruto, por ai përfiton vetëm pagën neto, ku zbriten sigurimet dhe tatimet.

Julian Hodaj – Po.

Antoneta Dhima – Nëse do t’i referohem pagës mujore...

Julian Hodaj – Nuk po ju kundërshtoj, por po them që është praktikë e konsoliduar dhe VKM-ja e detajon. Ne kemi pasur ndonjëherë problem me këtë pikë dhe nuk besoj që do të kemi. Gjithsesi, është në dorën tuaj, nëse doni ta specifikoni.

Ermonela Felaj – Kush është dakord që të votohet neni 53, me specifikimin e bërë nga kolegja Dhima, për sa i takon ndihmës së menjëhershme financiare, deri në 10 paga mujore, sipas pagës neto të muajit të fundit të shërbimit? Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me kreun VIII të këtij ligji, “Disiplina”

Neni 54 “Sjellja dhe etika”. Është një nen me përmbajtje të përgjithshme. Kush është dakord me këtë nen? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 55 “Shkeljet e disiplinës”. Për këtë nen nuk ka pasur kundërshtime. Kush është dakord?

Zonja Xhina ka një ndërhyrje.

Elena Xhina – Vë re që gjatë dispozitës parashikohet edhe e drejta e ankimit, e cila nuk përputhet shumë dhe titullin e dispozitës. Mos duhet ta vendosim shkeljen e disiplinës tek e drejta e ankimit? Pra, janë parashikuar tek e njëjta dispozitë dispozite, nuk janë të ndara.

Ermonela Felaj – Në fakt, shkelje disiplinore është çdo veprim apo mosveprim i punonjësit, që bie në kundërshtim me këtë ligj dhe rregulloren e Gardës. Shkeljet kategorizohen në shkelje të lehta dhe të rënda. Pastaj vazhdojmë me ankimin.

Në fakt, ndërhyrja është e drejtë dhe ndoshta ky nen duhet ndarë në dy pjesë, në “Shkeljet e disiplinës” dhe “Ankimi”. Si mendoni, zoti Hodaj, a mund ta ndajmë këtë nen në dy pjesë?

Julian Hodaj – Për sa kohë nuk ndryshohet thelbi i dispozitës, nuk përbën problem, zonja kryetare.

Ermonela Felaj – Dakord. Kush është dakord me nenin 55 të projektligjit me diskutimin që u mbajt? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 56 “Masa disiplinore”. “Punonjësit që kryejnë masa disiplinore ndëshkohen”.

Artemis Malo – Këtu është dakordësuar që të qëndrojë versioni i ministrisë, pasi nuk mund të këtë lirim kur merret masa disiplinore, por përjashtim. Pra, konkretisht nga qeveria është propozuar ky variant: “Punonjësi që kryen shkelje disiplinore ndëshkohet. Për shkelje të lehta disiplinore me masat: vërejtje dhe vërejtje me paralajmërim. Për shkelje të rënda

disiplinore me masat: mbajtjen deri një të tretën e pagës së plotë mujore, shtyrje të afatit të gradimit deri në 2 vjet ose përjashtim nga Garda e Republikës. Masa disiplinore shuhet pas kalimit të këtyre afateve, të cilat janë të ndarë në 3 pika.

Efektet e masës disiplinore për punonjësin fillojnë pas përfundimit të procesit disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të ankimit.

Punonjësi administrativ, për shkeljet e kryera, ndëshkohet me masë disiplinore të përcaktuar në kontratën e punës.

Procedurat për zbatimin e këtij neni përcaktohen në Rregulloren e Gardës”. Pra është dakordësuar që të qëndrojë versioni i Ministrisë së Brendshme.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Duke parë nenet 55 dhe 56, ky është një sugjerim për ju, zoti Hodaj, mendoja që këto dy nene mund të shikohen në raport me njëri-tjetrin në rastin kur diskutuam që ta ndanim nenin 55. Pra, mendoj që mund të bëjmë një integrim të nenit 55 me nenin 56 dhe të nxjerrim veçmas ankimet, që të jetë më e qartë. Pra, në fillim parashikohet se çfarë përbën shkelje disiplinore, çfarë masash jepen për shkeljet disiplinore dhe pjesa e fundit do të jenë të drejtat për t’u ankuar në lidhje me masat. Kjo mund të rishkruhet, nuk mendoj që është një vështirësi e madhe.

Julian Hodaj – Zonja kryetare, ne jemi dakord.

Ermonela Felaj – Kalojmë te neni 57.

Antoneta Dhima – Kryetare, edhe te germa “b” për shkelje të rënda disiplinore me masë, e para, mbajtja deri në një të tretën e pagës së plotë mujore. Pra, kemi dy koncepte, të pagës bruto dhe neto. Pagës së plotë mujore i bie që është paga bruto, pra kjo duhet të specifikohet. Është e njëjta gjë si në komentet e mësipërme.

Ermonela Felaj – Këtë do t’ua lëmë përfaqësuesve të ministrisë të na e thonë, sepse ne nuk duam të futemi në detaje, që nuk i njohim dhe nuk janë përgjegjësi jona, nëse do të jetë e nevojshme.

Kalojmë te simbolet e Gardës së Republikës.

1. “Garda e Republikës identifikohet me flamurin dhe stemën.
2. Flamuri dhe stema miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Kush është dakord me nenin 57? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 58 “Uniforma dhe shenjat dalluese”. Kush është dakord me nenin 58? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 59 “Dokumenti i identifikimit”. Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 60 “Festa e Gardës së Republikës”. “Festa e Gardës së Republikës është data 24 qershor”.

Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu i X “Armët, pajisjet, pajisjet kufizuese, përdorimi i forcës dhe mjetet e transportit”.

Neni 61 “Armët, pajisjet dhe mjetet”. Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 62 “Përdorimi i forcës”. “Punonjësi nuk e përdor forcën, me përjashtim të rasteve me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për sigurimin e personalitete të larta shtetërore dhe objekteve, për vetëmbrojtje dhe vetëm për të ndaluar aktet e dhunshme. Në këto raste, forca përdoret si mjet i fundit dhe nuk ka karakter ndëshkues.

Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

Në çdo rast ndalohet përdorimi i forcës për qëllime trajtimi çnjerëzor ose degradues”.

A kemi ndonjë diskutim për këtë nen? Jo. Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu XI “Burimet Financiare”. Këtu na qartësohet edhe pika e burimeve financiare dhe asetet.

Neni 63 “Buxheti i Gardës parashikon”.

1. “Buxheti i Gardës është program i veçantë brenda buxhetit të Ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike.

2. Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm të Gardës së Republikës për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, menaxhimin financiar dhe kontrollin, ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve në përdorim ushtrohen sipas legjislacionit financiar në fuqi”.

A jemi dakord zonja Dhima?

Antoneta Dhima – Dakord.

Ermonela Felaj – Kush është dakord me nenin 63? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 64 “Donacionet dhe sponsorizimet”, të cilat janë një tjetër burim financimi.

1. “Garda pranon donacione dhe sponsorizime. Pranimi, administrimi dhe përdorimi i tyre bëhen në bazë të legjislacionit në fuqi”.

Kush është dakord me nenin 64? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu XII “Certifikatat”.

Neni 65 “Certifikata për shërbim të dalluar dhe karrierë”. Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 66 “Llojet e certifikatave”. Kush është dakord me këtë nen? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në kreun e fundit të ligjit, “Dispozitat kalimtare dhe zbatuese”.

Neni 67 “Kalimi në sistemin e ri të gradave”. Thamë se një nga risitë që sjell ky projekt është ndryshimi i sistemit të gradave. Ligji sigurisht që ka nevojë për një dispozitë kalimtare, që kalimi të ndodhë pa pasoja për punonjësit e Gardës së Republikës, në kuptimin e përfitimeve financiare.

a) Gradat: “Rreshter”, “Kapter i katërt”, “Kapter i tretë” dhe “Kapter i dytë”, ekuivalentohen me gradën “Inspektor”.

b) Gradat: “Kapter i parë”, “Kapter mjeshër” dhe “Kapter shtabi” ekuivalentohen me gradën “Inspektor i dytë”.

c) Gradat: “Kapter” dhe “Kryekapter” ekuivalentohen me gradën “Inspektor i parë”.

d) Gradat: “Nëntoger” dhe “Toger” ekuivalentohen me gradën “Nënkomisar”.

e) Gradat: “Nënkapiten” dhe “Kapiten” ekuivalentohen me gradën “Komisar”.

f) Grada “Major” ekuivalentohet me gradën “Kryekomisar”.

g) Grada: “Nënkolonel”, ekuivalentohet me gradën “Drejtues”.

h) Grada “Kolonel” ekuivalentohet me gradën “Drejtues i parë” dhe/ose “Drejtues i lartë”.

i) Grada “Gjeneral”, ekuivalentohet me gradën “Drejtues madhor”.

Ky është propozimi, që bëhet për nenin 67 të projektligji. Pra, ky do të jetë njësimi që do të ndodhë.

A ka ndonjë pyetje nga kolegët? Unë lexova çdo gjë, që punonjësit e Gardës të jenë të qartë se çfarë ndryshimi do të ndoll me gradat.

Kush është dakord me nenin 67? Dakord, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 68 “Trajtimi gjatë periudhës transitore”.

1. “Kalimi nga sistemi i gradave të fituara sipas ligjit aktual dhe gradat sipas këtij ligji bëhet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”. Pra, besoj se është e nevojshme që të lihet një kohë në dispozicion.

2. “Nëse numri i gradave është më i lartë se numri respektiv i funksioneve korresponduese për çdo gradë, punonjësi merr gradën që i korrespondon funksionit të lirë dhe nëse nuk pranon, ai lirohet me gradën e fituar.

3. Nëse numri i gradave është më i ulët se numri përkatës i funksioneve korresponduese për çdo gradë, kompletimi organik deri në përfundim të procesit të konkurrimit për ecurinë në gradë bëhet nga punonjës që mbajnë një gradë më të ulët se ajo që i korrespondon funksionit të pakompletuar.

Pika 4: “Trajtimi financiar i punonjësve gjatë qëndrimit në punë deri në momentin e hyrjes në fuqi të akteve nënligjore përkatëse, të parashikuara në këtë ligj, do të vazhdojnë të bëhen sipas dispozitave të akteve të mëparshme nënligjore”.

Pra, kalimi në vetvete e implikon financën, ndaj i gjithë diskutimi për kolegët besoj nëse 6 muaj është kohë e mjaftueshme që ky kalim të ndodh, apo është kohë e gjatë? A ka ndonjë diskutim për këtë?

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit, kryetare!

Unë mendoj se evidentimi dhe përshtatshmëria, sipas ligjit, është e shkruar shumë qartë. Koha 6 muaj mendoj se është shumë kohë e gjatë. Unë propozoj të jetë një afat 4-mujor. Nuk ka pse të lihet kaq gjatë, sepse Garda e ka dokumentacionin, sistemimi do të bëhet, dhe në kushtet kur ka kërkesa, mendoj që afati të jetë 4-mujor. Mund të jetë edhe 3-mujor, por them 4-mujor, për shkak se edhe procedurat duhen kryer në rregull dhe korrekt me ndryshimet e ligjit që ne po diskutojmë sot.

Ermonela Felaj – Dua të dëgjoj edhe përfaqësuesit e ministrisë, sepse është edhe neni 700 “Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore”, ku parashikohet afati 6-mujor për nxjerrjen e

akteve nënligjore kryesore dhe parashikohet që efektet financiare për një tërësi aktesh nënligjore, që detyron ky ligj, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2024.

Në raport me këto nene dua të kem një përgjigje nga zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Zonja kryetare, ju sapo e shpjeguat që është kohë e nevojshme që të adoptohen të gjithë aktet nënligjore që kërkohen. Nuk është një afat që e ka caktuar Ministria e Brendshme, por ka ardhur si propozim i Gardës, sepse besoj që edhe atyre u duhet koha e nevojshme për riorganizim.

Ju e përmëndët edhe argumentin tjetër për nenin 70, për të cilin unë nuk do të zgjatem, por besoj se 6 apo 4 muaj nuk ndryshon ndonjë gjë në logjikën e përgjithshme. Më mirë 6 muaj, që të marrin kohën e nevojshme, në mënyrë që edhe aktet nënligjore që do të propozohen të shqytohen, të miratohen, të diskutohen, që të jenë të një cilësie të mirë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A kemi opinione të tjera nga kolegët? Cila kohë ju duket më oportune për 6 muaj apo për 4 muaj?

Dakord.

Ju ftoj pastaj të votoni për opsionin që Garda e Republikës është dakord, pra për 6 muaj.

Po, zonja Dhima.

Antoneta Dhima – Zonja kryetare, e rëndësishme është që ta miratojmë ligjin dhe të zbatohet sa më shpejt. Dua të di nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme: a është përlllogaritur një kosto nga zbatimi i këtij ligji?

Unë e kuptoj që me afatin 6 muaj, lëvizjet, zhvendosjet ose njësimi i gradave ka një kosto. A ka një përlllogaritje nga ana e ministrisë, sepse afati është i lidhur edhe me kosot?

Julian Hodaj – A mundem, zonja kryetare?

Ermonela Felaj – Po.

E kishim trajtimin gjatë periudhës tranzitore, në bazë të akteve nënligjore që tashmë janë në fuqi; e kishim te neni paraardhës, që do të thotë se gjatë muajve të tranzicionit nuk do të ndryshojë asgjë në trajtimin edhe financiar të punonjësve. Për sa u përket kostove në total të këtij procesi, besoj se është edhe te relacioni i projektligjit, që patëm mundësi ta diskutonim kur e miratuam në parim, që nuk ka kosto shtesë për buxhetin e shtetit, sepse buxheti që përdor sot Garda e Republikës e lejon edhe këtë lloj transformimi, pa i kushtur më shumë fondeve publike.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Atëherë, jemi të qartë.

Mendoj se koha vlen, sepse jemi edhe në kushtet e pandemisë dhe gjërat nuk janë lehtësisht të parashikueshme, ndaj më mirë t'u lëmë kohë në dispozicion, sesa ta zvoglojmë kohën, çka mund të sillte një ndërhyrje tjetër në ligj për një gjë kaq të thjeshtë.

Kush është dakord me nenin 68?

Miratohet.

Neni 69 "Rregullorja e Gardës", i cili do të jetë një akt që do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk kam vërejtje për nenin 69, por dua të sjell në vëmendje diçka që e diskutova edhe në parim, ndoshta për të mbetur në rekord të këtij diskutimi.

Në nenin 20, siç e theksova, kemi përmendur kriteret për pranimin në Gardën e Republikës. Unë dua edhe një herë nga zoti Hodaj të na thotë nëse këto kritere do të kenë efekt te punonjësit aktual të Gardës? A lind nevoja që ne të themi se neni 20 nuk gjen zbatim për punonjësit, që, aktualisht, janë pranuar në Gardë dhe kanë funksionet e tyre? Dua një mendim lidhur me këtë, sepse besoj se do t'u shërbejë edhe atyre, nëse e kanë këtë vështirësi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zoti Hodaj.

Julian Hodaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zonja Xhina!

Unë e thashë në diskutimin në parim dhe e përsëris: ndryshimi nuk ka efekt për punonjësit ekzistues. Neni që ju përmëndët, i lexuar së bashku me nenin 67, që është kalimi në sistemin e ri të gradave, pra ekuivalentimi, do të thotë: të lexuar të dyja bashkë, garantohet që të gjithë ata punonjës, që janë, të kalojnë në sistemin e ri dhe të vazhdojnë të jenë punonjës të Gardës së Republikës.

Neni që ju përmëndët për kriteret e pranimit është për ata që sot e tutje, meqënëse i kemi futur në një sistem të ri pranimi, që tashmë do të kalojnë nëpërmjet Akademisë së Sigurisë, siç kemi futur edhe një sistem të ri, ecurinë në karrierë, që kalon nëpërmjet Akademisë së Sigurisë dhe kurseve, që ofrohen për gradat e tjera të ndërmejtme, po nga Akademia e Sigurisë; kemi jetësuar premtimin që është bërë që në vitin 2017, që Akademia e Sigurisë nuk do të ishte thjesht një institucion që i shërben Policisë së Shtetit, por do t'i shërbejë edhe institucioneve të tjera të sigurisë publike në vend.

Në këtë pikë, e përsëris për herë të fundit edhe një herë, nëse nuk më kanë dëgjuar: nuk ka efekte për punonjësit ekzistues të Gardës së Republikës. Pra, do të jetë një kalim nga një sistem gradash në një sistem tjetër. Institucioni do të riorganizohet, por duke u mbështetur në ato burime materiale, që janë në dispozicion sot.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Ndërkohë që ju po jepnit përgjigje, unë po shikoja parashikimet e ligjit aktual për gardistët, kriteret janë: arsim i mesëm, të mos jenë të dënuar, të kenë sjellje të mira qytetare, të jenë fizikisht jo më pak se 1,75 cm, kriter që nuk e gjejmë më, pra këtë të gjatësisë; është ezauruar dhe nuk do të penalizohet njeri, se ka hyrë më i shkurtër.

Për nënoficerët gardistë: duhet të kenë kryer shërbimin ushtarak, të jenë të diplomuar në Institutin e Policisë ose në kurse të barazvlefshme.

Për oficerët gardistë: të jenë të diplomuar në Akademinë e Policisë, në Akademinë e Mbrojtjes, ose të jenë me arsim të lartë për specialitete të veçanta.

Për oficerët e lartë të gardës: përveç këtyre duhet të kenë kryer edhe kurse kualifikimi në përputhje me funksionin që kryejnë.

Pra, konfigurimi i ri i kriterëve nuk penalizon dikë.

Kush është dakord me nenin 69? Po, faleminderit!

Miratohet.

Neni 70 “Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore”. Këtë nen gjykoj se e diskutuam pak a shumë.

Kush është dakord me nenin 70? Po, faleminderit! Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Julian Hodaj – Kryetare, a mundem?

Ermonela Felaj – Po.

Julian Hodaj – Meqënëse ndryshuam disa pika gjatë rrugës, do t’jua dërgojmë të përditësuara.

Ermonela Felaj – Po, patjetër.

Julian Hodaj – Faleminderit!

Ermonela Felaj – Neni 71 “Shfuqizimet”

Ligji nr.8869, datë 22.5.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, dhe ligji nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së

Shqipërisë”, si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore në fuqi që bien ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Jeni dakord?

Miratohet.

Neni 72 “Hyrja në fuqi”, që parashikohet të jetë 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kush është dakord me këtë nen? Po, faleminderit!

Miratohet.

Para se të vendosim, do të doja të pyesja zotin Hodaj.

Nëse mundeni, brenda ditës së nesërme, ju të na siguronit tekstin e zbardhur të ligjit me të gjitha diskutimet që ne bëmë gjatë ditës së sotme? Apo duhet që mbledhjen ta fiksoj jo nesër, por pasnesër? Dua të dakordësohem me ju për kohën.

Julian Hodaj – Për nenet që u ndryshuan, besoj se brenda ditës së nesërme jemi gati t’i sjellim versionet e zbardhura dhe kuptohet, t’i reflektojmë edhe në tekstin përfundimtar, gjithmonë në bashkëpunimin me shërbimin e komisionit.

Ermonela Felaj – Dakord.

Nesër ne do të kemi një ditë relativisht të ngarkuar, sepse do të fillojmë diskutimin nën për nen të projektligjit “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Burgje”, ndaj do të gjykoja që teksti të jetë gati rreth mesditës, ndërkohë t’i vënë pararakisht në dispozicion të të gjithë kolegëve të Komisionit të Sigurisë, me qëllim që në mbarim të diskutimit të pikës së parë të renit të ditës, ne të bëjmë edhe votimin në tërësi dhe ta mbyllim diskutimin për ligjin e ri të Gardës.

Jeni dakord?

Ndoshta mund ta vendosim edhe si pikë të parë të rendit të ditës, por nëse mendoni se mund të dojë pak kohë, mund ta shtyjme.

Julian Hodaj – Thjesht për ta zbardhur pikë për pikë atë që ju vendosët. Për ne nuk ka problem.

Ermonela Felaj – Ditën e nesërme teksti do të jetë në dispozicion për kolegët e Komisionit të Sigurisë. Njëkohësisht, do të jemi në gjendje të bëjmë edhe votimin në tërësi, që diskutimi të mbyllet dhe ky ligj të jetë gati për votim në seancë plenare.

I falënderoj kolegët dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Brendshme për të gjitha diskutimet e ditës së sotme!

E falënderoj relatoren, sepse e di shumë mirë që gjatë ditës së djeshme ka qëndruar me grupin e punës për të siguruar përmbajtjen e projektligjit që diskutuam sot!

Ditë të mbarë!

Njoftimin për ditën e nesërme do ta merrni nga stafi i komisionit.
Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA